



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 6.12.2024, ora 11:00

TRYEZË TEMATIKE PUBLIKE X

Drejton tryezën: Eralda Methasani

Rendi i ditës:

“Qeverisja e hapur”.

Marrin pjesë:

Eralda Methasani, Fatmir Xhafaj, Milva Ekonomi, Eduard Shalsi dhe Besarta Vladi.

Të ftuar:

Migena Leskoviku, Klesta Hysi, Delina Ibrahimaj, Juljana Hoxha, Tedi Dobi, Arjan Dyrmishi, Aleksander Mascoviç, Adrian Kamenica, Erjona Fishta, Elona Hoxhaj, Gaspër Gjeluci, Aranita Brahja, Krisela Haçkaj, Xheni Dimraj, Evgjenui Virno, Gerti Shella, Zoran Jachev, Jolanda Trebicka, Erjola Vejtati, Dorida Kafexhiu, Ribor Drascovic, Majlinda Dhuka, Basil Hahn, Isabele Tomas Delic, Taulant Balla, Luigi Mattirido, Endri Teta, Ermelinda Pema, Kejsi Rizo, Eniana Qarri, Marcela Kërceku, Amanda Kote, Maleh Dema, Vanina Jakupi, Elkeda Domi, Aliosha Brokaj, Viktor Gjoni, Etleva Bajrami, Kaliro Duraj, Jon Kola, Reald Keta, Romina Kostani, Dorela Shkëmbi, Alisa Limaj, Zef Preçi, Stela Suloti, Anita Lushi, Loren Kaçollari dhe Blerta Tuci.

HAPET MBLEDHJA

Eralda Methasani – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Mirë se keni ardhur në tryezën e radhës “Qeverisja e hapur”, të mbajtur në kuadër të një angazhimi me rëndësi për vendin tonë, një rishikimi në mënyrë gjithëpërfshirëse të veprimtarisë në vend, me qëllim ndryshimin e mirëqeverisjes në Republikën e Shqipërisë.

Tryeza e sotme do të përqendrohet në qeverisjen e hapur.

Dy janë temat kryesore ku do të përqendrohemi: e para, transparencja e administratës publike dhe, e dyta, llogaridhënia e institucioneve të pushtetit vendor dhe qendror.

Unë nuk do të marr fare kohë, me qëllim që të jemi sa më shumë aktivë në tryezën e sotme.

Fjalën do t’ia jap më së pari zonjës Hysi.

Klesta Hysi – Faleminderit, profesoreshë Methasani!

Përshëndetje të gjithëve!

Në emër të grupit të punës për kapitullin e transparencës, në kuadër të shtyllës së Mirëqeverisjes, do të përpiqem të bëj një prezantim të shkurtër. Materiali përmbledhës gjendet në *uebsajtin* e ngritur në kuadër të komisionit *ad hoc* që funksionon pranë Kuvendit. Do të bëjmë një prezantim konçiz duke u fokusuar kryesisht tek arritjet dhe problemet kryesore, si dhe te disa rekomandime që grupi i punës ka evidentuar, që më pas të lëmë mundësinë për rekomandime dhe sugjerime që edhe ne të kemi mundësi për të përmirësuar draftdokumentin, i cili është ende në përpunim e sipër pasi presim komentet e grupeve të interesit, përfaqësuesve të institucioneve dhe të ministrive të linjës.

Kapitulli “Transparenca” ka pasur në fokus kuadrin ligjor në Shqipëri në fushën e transparencës me fokus kryesisht ligjin “Për informimin” dhe legjislacionin në fushën e konsultimit publik, mekanizmat institucionalë që funksionojnë në vend në këtë fushë, disa elemente që lidhen me pjesëmarrjen e qytetarëve dhe grupeve të interesit në konsultimin e akteve, si dhe vlerësimin e ndikimit rregullator, dy elemente këto që lidhen tërthorazi me transparencën dhe një politikë më të përgjegjshme.

Analiza nuk është shteruese. Ka pasur disa kufizime.

Në tryezën e sotme nuk e kemi shumë në fokus transparencën e financave publike, transparencën e vetë Kuvendit dhe të organeve të sistemit të drejtësisë, si dhe qeverisjen elektronike, sepse këto tri tema janë trajtuar në kapituj të veçantë dhe ka pasur grupe pune të

dedikuara për këto fusha, si dhe tryeza ku shumica e pjesëmarrësve sot i ka ndjekur në tryezat e mëparshme për këto tri drejtime.

Dokumentet strategjike në vend, edhe në kuadrin tashmë të fazës ku gjendet Shqipëria për shkak të procesit të integritetit, që janë marrë në referate dhe kanë në fokus transparencën, janë:

Udhërrëfyti për Reformën në Administratën Publike, i cili ka objektiva dhe zotime të dedikuara të shtetit shqiptar në lidhje me transparencën dhe pjesa më e madhe e këtij udhërrëfyti, në fakt, i dedikohet konsultimit të akteve;

Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027, e cila transparencën e shikon si një çështje horizontale në të gjitha shtyllat e kësaj agjende dhe ka një element të dedikuar për transparencën dhe llogaridhënien në lidhje me shtyllën e shtetit të së drejtës dhe atë që quhet “Themeloret”.

Ndërkohë, reformën e administratës publike, si një nga elementet e procesit të integritetit dhe objektivat e saj, presim ta shohim të pasqyruar në Strategjinë e re për Reformën në Administratën Publike 2024-2030, ku pritet që një kapitull i veçantë t’i dedikohet pikërisht transparencës.

Strategjia Ndërsektoriale për Qeverisjen Vendore, gjithashtu, ka objektiva në lidhje me procesin e transparencës dhe llogaridhënies.

Shqipëria në vitin 2024 e gjen veten, pas vitesh të tëra ndërhyrjesh ligjore, amendimesh dhe iniciativash ligjvënëse, me një kuadër ligjor që vlerësohet pozitivisht, sidomos në drejtim të ligjit “Për informimin”. Ndryshimet e vitit të kaluar e kanë përmirësuar edhe më tej këtë kuadër ligjor.

Në lidhje me konsultimin publik, ka një legjislacion në fuqi që vlerësohet relativisht pozitivisht, por jo në atë shkallë vlerësimi siç është vlerësuar ligji “Për informimin”.

Në vitin 2022 patëm dy ndërhyrje nga Kuvendi, dy nisma dhe dy ligje të miratuara në Kuvend “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për akses në dokumentet zyrtare” dhe u miratua ligji “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimi i informacionit në sektorin publik”, i cili ka përafruar direktivën e Bashkimit Europian me të njëjtin titull.

Në Shqipëri të gjitha autoritetet publike për momentin kanë caktuar Koordinatorin për të Drejtën e Informimit dhe 305 autoritete publike kanë publikuar dhe përditësuar Programin e Transparencës. Këto janë statistika të deri para dy muajve, kur është hedhur për konsultim drafti i parë i dokumentit.

Qeverisja vendore ka 28 plane integriteti të miratuara për momentin.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore synon që brenda këtij viti ta rrisë këtë numër në 35 plane të tilla, ndërkohë që është thënë disa herë në tryezat e mëparshme se Shqipëria e gjen veten në vitin 2024 me një rekord pozitiv duke ofruar 95% të shërbimeve *online* dhe 1242 shërbime elektronike.

Numri i ankesave që shqyrton Komisioneri për të Drejtën e Informimit mbetet relativisht i lartë, një trend i qëndrueshëm për tre vjetët e fundit, me rreth 1000 ankesa në vit, nga të cilat 600 shqyrtohen zakonisht dhe marrin zgjidhje gjatë fazës së hetimit administrativ nga Komisioneri dhe kap mesatarisht 45 deri në 50 vendime në vit, ku fokusin më të madh në vendimmarrje Komisioneri e ka te ligji “Për informimin” dhe disa prej vendimeve fokusohen te programet e transparencës.

Nëse do të bënim një krahasim të organeve mes tyre, organet e pavarura paraqiten me nivel transparence më të lartë. Vetë Kuvendi renditet si organi me transparencën më të lartë. Paralelisht Shkolla Shqiptare e Administratës Publike punon për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin dhe rritjen e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike, duke ofruar periodikisht në kurrikulën e saj trajnime të dedikuara për informimin, vlerësimin e ndikimit rregullator dhe konsultimin publik.

Viti 2023 shënoi edhe vitin më të lartë të komenteve të mbledhura në kuadër të procesit të konsultimit publik me 848 komente në vitin 2023, por drejtoria respektive në Këshillin e Ministrave që punon në këtë fushë parashikon se edhe viti 2024 do të mbyllet me një trend pozitiv.

Pavarësisht arritjeve, në bazë të progresraportit, raportit *Screening* dhe në bazë të raporteve të shoqërisë civile, ekspertët që kanë punuar për këtë kapitull kanë evidentuar disa sfida dhe probleme.

Së pari, të gjitha raportet njëzëri unifikohen në drejtim të rolit që duhet të kenë koordinatorët e informimit, një rol më të forcuar, si dhe të ketë një qëndrueshmëri më të madhe.

Komisioneri raporton për një mungesë ndërgjegjësimi nga ana e administratës publike për të publikuar në mënyrë proaktive të dhënat nëpërmjet programeve të transparencës.

Qeverisja vendore ka një situatë pak më problematike në raport me organet e tjera.

Për momentin, nga 61 njësi të qeverisjes vendore rezulton se vetëm 21 prej tyre janë klasifikuar me transparencë proaktive të lartë, 43 të tjera me transparencë mesatare dhe pjesa e mbetur me transparencë të ulët ose shumë të ulët. Ndërkohë, Komisioneri raporton për një problematikë sa i përket procesit të njoftimeve dhe konsultimit në njësitë e qeverisjes vendore.

Grupet e marginalizuara dhe personat me aftësi të kufizuar janë përmendur shpesh edhe në tryeza të tjera se kanë nevojë për një fokus të rritur, mungojnë politika të dedikuara për transparencën për t'u dhënë akses këtyre grupeve në konsultim dhe në informacion; po ashtu vërehet paqartësi nga ana e autoriteteve publike sa u përket të dhënave konfidenciale të kontratave duke përmendur shpesh konfidencialitetin si kriter kufizues për aksesin në informacion, kriter ky që sipas të dhënave dhe raporteve përmendet dhe përdoret si kriter, në fakt, në kundërshtim me parashikimet e ligjit në fuqi “Për informimin”.

Ndërkohë që Avokati i Popullit ka nxjerrë në pah, nëpërmjet rekomandimeve të tij, se ka shpesh mungesë transparence dhe mungesë reagimi për rekomandimet e vetë institucionit, duke penguar kështu hetimin administrativ, dukuri kjo e theksuar më së shumti në organet e qeverisjes vendore.

Procesi i konsultimit dhe vlerësimit të ndikimit rregullator nuk zbatohet për momentin për aktet nënligjore dhe për projektligjet, ligjet në fuqi, ai ka një gamë të gjerë aktesh që i lë jashtë procesit të konsultimit, ndërkohë që përqindja e akteve që konsultohen *online* mbetet e ulët në raport me numrin total të akteve që miratohen dhe shpesh OJF-të vendase raportojnë se procesi i konsultimit konsiderohet si formal.

Në lidhje me nevojën për adresime dhe për disa rekomandime në këtë fushë grupi i punës ka punuar në tri drejtime: rekomandime në kuadër të nevojës për përmirësime ligjore, rekomandime për punën e vetë Kuvendit dhe disa rekomandime më makro, që lidhen me procesin e transparencës dhe konsultimit.

Ne vlerësojmë se ligji “Për konsultimin publik”, sikurse në fakt është parashikuar edhe në Udhërrëfyesin për Administratën Publike, ka nevojë të amendohet për të zgjeruar kategoritë e akteve që i nënshtrohen procesit të konsultimit, ka nevojë për një qëndrueshmëri më të madhe të koordinatorëve të informimit dhe ata për konsultimin dhe njoftimin publik, duke vlerësuar nevojën për një ndryshim ligjor për t'u dhënë një rol më kyç koordinatorëve dhe mundësinë që këto pozicione të mbulohen nga nëpunës të nivelit të mesëm apo të nivelit të lartë.

Ndërkohë, kapacitetet e organeve të pavarura, si Avokati i Popullit dhe Komisionieri për të Drejtën e Informimit, do të duhet të jenë në fokus të Kuvendit për t'u forcuar, si organet kyçe në vend që monitorojnë këto fusha dhe që sigurojnë transparencën e institucioneve publike. Kuvendi vetë do të duhet të rrisë ndjeshmërinë në raportimet vjetore pranë tij nga organet e pavarura dhe organet e tjera të administratës. Edhe udhëzuesi që Kuvendi ka në fuqi, për raportimin

e këtyre organeve, ka nevojë për përmirësime, për t'u fokusuar më shumë në çështjet e transparencës dhe llogaridhënies së këtyre institucioneve. Gjithashtu, ka nevojë për dëgjesa të dedikuara me OJF-të dhe me përfaqësues të mediave. Kuvendi do të duhet të dëgjojë drejtpërdrejt zërin e këtyre aktorëve për problemat që ata hasin në kuadër të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit dhe konsultimin e akteve.

Qeverisja vendore ka një ritëm më të ulët për sa u përket politikave të transparencës. Nevojitet një reformë e thellë në këto institucione për të çuar zërin e qytetarëve më afër këtyre institucioneve, si dhe për të garantuar transparencë më të madhe. Në këtë kuadër nevojitet një forum apo platformë periodike dialogu dhe e qëndrueshme mes Kuvendit, ekzekutivit, qeverisjes vendore dhe organeve të pavarura, në kuadër të sfidave të procesit të integritetit, sigurisht me fokus transparencën, pjesëmarrjen dhe llogaridhënien.

Në lidhje me procesin e ndikimit rregullator, ne sugjerojmë të ngihet në nivelin e një ligji, pasi për momentin rregullohet me akte nënligjore.

Sa u përket personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të marxhinalizuara, sugjerojmë një përshtatje të informacionit, metoda më interaktive, ndërsa për grupe si fëmijët apo të rinjtë, metoda edhe më kreative të konsultimit dhe të informimit të dokumenteve dhe të informacioneve publike.

Ne kemi hedhur për diskutim disa teza publike, për të cilat mund ta hapim diskutimin më vonë, nuk janë kufizuese, janë thjesht orientuese për efekt të debatit. Tezat janë: si mund të rritet efektiviteti i ligjit për informimin, çfarë çështjesh do të donim të shikonim të mbuluara më mirë në raportin e Komisionerit, me qëllim që qytetarët të kenë një panoramë më të plotë, njëkohësisht edhe Kuvendi, se si zbatohet ligji për informimin? Si mund të rritet transparenca e qeverisjes vendore? Çfarë roli mund të luajë Kuvendi? Çfarë mekanizmash ligjore edhe kushtetuese mund të përdorë, por sigurisht pa cenuar autonominë vendore të pushtetit lokal? Çfarë ndërhyrjesh ligjore dhe institucionale vlerësoni ju se janë të domosdoshme në kuadër të përmirësimit të procesit të konsultimit dhe nëse ju keni sugjerime për nisma dhe politika konkrete, që mund të ndërmerren nga institucionet për të rritur konsultimin publik dhe informimin e grupeve të marxhinalizuara dhe të personave me aftësi të kufizuara.

Faleminderit!

Eralda Methasani - Shumë faleminderit, zonja Hysi, edhe për qëndrimin të çështjet më themelore!

Ne do të kemi një diskutim në vijim, por tani dëshiroj t'ia jap fjalën zonjës Migena, për të ndarë gjetjet e grupit të tyre të punës në lidhje me llogaridhënien. Ndërkohë që presim, në fakt, duhet të kujtojmë që llogaridhënia është një nga gjashtë shtyllat themelore të parimeve të administratës publike, të kërkuara edhe në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Fjala për ju, zonja Leskoviku.

Migena Leskoviku - Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Faleminderit të gjithëve!

Kam kënaqësinë që në emër të grupit që ka përgatitur pjesën e llogaridhënies së institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor të bëj prezantimin e analizës sonë, e cila, sigurisht, është më e zgjedhur në varianti final dhe do të përmirësohet duke pasur parasysh *feed back*-un dhe komentet që ne kemi marrë dhe do të marrim nga tryezat publike, që zhvillohen për këtë qëllim, si dhe duke reflektuar gjetjet kryesore të progresraportit të Bashkimit Evropian për vitin 2024.

Duke thënë këtë, dua të falënderoj, gjithashtu, edhe Kuvendin për mbështetjen, jo vetëm deputetët që na kanë asistuar, por edhe të gjitha strukturat administrative të Kuvendit, për të mundësuar një koordinim mes nesh dhe, sigurisht, për të finalizuar me sukses këtë analizë!

Referuar gjetjeve tona, sigurisht është e rëndësishme të theksojmë se llogaridhënia në kuadër të përcaktimeve që ka bërë Bashkimi Evropian konsiderohet si një nga elementet kryesore për të vlerësuar cilësinë e administratës publike dhe çdo nevojë për reformim, duke pasur parasysh që organizmi i saj duhet të jetë sa më efikas dhe efektiv në të gjitha nivelet e qeverisjes. Organet e administratës publike duhet të jenë të hapura dhe transparente dhe të zbatojnë mekanizma të përcaktuar qartë të llogaridhënies së brendshme dhe të jashtme dhe, po ashtu, organet mbikëqyrëse duhet të garantojnë mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe interesin publik. Theksoj që pjesa e llogaridhënies është, po ashtu, një nga treguesit kryesorë që ka të bëjë edhe me qeverisjen e hapur. Në përgjithësi, po t'i referohemi vlerësimit të përgjithshëm të Komisionit Evropian, pra po t'i referohemi strukturës, progresit dhe arritjeve, nga njëra anë dhe, më pas, gjetjeve, problematikave, disa rekomandimeve të rëndësishme, vlerësimi i përgjithshëm i Komisionit Evropian në të dyja raportet qoftë në raportin *screening* 2023 qoftë në raportin e progresit 2023 për Shqipërinë, vlerëson se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e reformës së administratës publike. Po ashtu, edhe raport progresi 2024 e evidenton këtë fakt duke theksuar përparimet që janë bërë, por duke evidentuar që ka nevoja për zbatimin e rekomandimeve të një viti më parë, të cilat enden mbeten të adresuara edhe në progresraportin e fundit.

Në lidhje me progresin dhe arritjet, në fakt, për efekt të trajtimit e kemi ndarë në dy shtylla; shtylla e parë lidhet me drejtimin strategjik, koordinimin e politikave dhe infrastrukturën institucionale dhe e dyta dedikuar vetëm legjislacionit, harmonizimit të tij me *acquis*-në e Bashkimit Europian.

Në vija të përgjithshme, sa i përket vlerësimit pozitiv, në lidhje me progresin e bërë, Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin Europian dhe Planin Kombëtar 2023-2025 për Integrimin Europian janë konsideruar si elemente pozitive për të përmirësuar zhvillimin dhe integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, ku ndër to përfshihet edhe qeverisja e mirë, e cila si një nga elementet kryesore ka edhe përmirësimin e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë.

Ajo që vlen për t'u përmendur në këto dokumente strategjike, në kuadër të integritetit në BE, është nevoja për monitorim rigoroz të të gjitha nismave dhe ecurisë së projekteve të ndërmarra nga shteti shqiptar me fokus veçanërisht llogaridhënien. E njëjta gjë vlen edhe për Planin Kombëtar për Integrimin Europian, ku llogaridhënia në kontekstin e këtij plani thekson përgjegjësinë e institucioneve publike për të raportuar, si dhe për të justifikuar veprimtarinë dhe vendimmarrjen e tyre. Ndër të tjera, ajo që theksohet në këtë dokument është edhe forcimi i mekanizmit të kontrollit të brendshëm, si një nga prioritetet e Planit Kombëtar për Integrimin Europian.

Duke iu referuar në tërësi reformës në administratën publike, sigurisht që aktualisht vlerësohet se ekziston korniza strategjike e reformës së administratës publike, e cila është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian dhe që monitorohet nga qeveria dhe palët e interesuara.

Gjithashtu, është miratuar në dhjetor të vitit 2023 edhe Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike 2023-2030. Gjithsesi, vlen të përmendim, prandaj edhe i kemi nënvizuar, tri strategji nga kjo kornizë strategjike, konkretisht Strategjia për Decentralizmin dhe Qeverisjen Vendore, Strategjia e Agjendës Digjitale, si dhe Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike, të cilat tashmë janë të përditësuara dhe mbetet që kjo kornizë strategjike e reformës në administratën publike të plotësohet edhe me dy strategji të tjera që janë, konkretisht, Strategjia e Reformës së Administratës Publike dhe Strategjia Antikorrupsion që pritet të miratohen së shpejti.

Lidhur me këtë kornizë strategjike, Komisioni Europian, posaçërisht ka vlerësuar miratimin e këtyre dy dokumenteve konkretisht Strategjinë Digjitale 2022-2026 dhe Strategjinë për Decentralizmin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030. Nga ana tjetër, i inkurajon autoritetet

shqiptare që të përmirësojnë këtë kuadër strategjik në kuadër të reformës së re të administratës publike dhe për miratimin e strategjisë tjetër, atë antikorupsion.

Nga pikëpamja e progresit të arritjeve, gjithmonë në kuadër të ndryshimeve në nivel politik dhe institucional, vlerësohet pozitivisht krijimi i postit të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe ai i ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorupsionit, ku vlerësohet pozitivisht emërimi i këtij të fundit, pra i Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorupsionit, i mandatuar me koordinimin e agjendës së reformës në administratën publike. Gjithsesi, theksohet nevoja për një udhëheqje të fortë politike për zbatimin e suksesshëm të reformave që përfshihen në kuadër të kësaj reforme.

Nga ana tjetër, kur flasim për çështje që kanë të bëjnë me ndryshimet institucionale të fundit, në kuadër të decentralizimit, posti i ri i ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor mbështetet edhe nga një agjenci, që është Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për të bërë të mundur realizimin e mandatit, në kuadër të decentralizimit dhe vetëqeverisjes.

Po ashtu, është me rëndësi të theksojmë këtu planet e integritetit, që tashmë janë të miratuara nga ministrinë e linjës dhe nga institucionet e tjera publike në vend, të cilat janë tregues i vullnetit politik, por edhe administrativ, për të ndërmarrë një proces vetëvlerësimi, si dhe për të hartuar një dokument strategjik, me qëllim, ndër të tjera rritjen dhe përmirësimin e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së institucioneve. Sërish, kur mbetemi te pjesa e progresit dhe e arritjeve, përveç këtyre dokumenteve strategjike apo disa prej ndryshimeve kryesore institucionale, nuk mund të lëmë pa përmendur legjislacionin në fuqi, që ne e kemi trajtuar për efekt të këtij kapitulli. Në vlerësim të përgjithshëm, si konkluzion, siç është paraqitur, ne vlerësojmë se tanimë janë vendosur bazat ligjore dhe strukturat institucionale për një sistem koherent të politikëbërjes.

Po ashtu, sa i përket mbikëqyrjes së administratës publike nga institucionet e pavarura, korniza legjislative në fuqi është përgjithësisht adekuate dhe siguron pavarësi të mjaftueshme për institucionet mbikëqyrëse, veçanërisht institucionet e pavarura kushtetuese, por dhe institucione të tjera që mbikëqyrin veprimtari administrative të caktuara. Pavarësisht kësaj, kjo nuk do të thotë që nuk ka nevojë për ndryshime në fushën ligjore, të cilat ne i kemi evidentuar edhe te pjesa e gjetjeve dhe e rekomandimeve.

Në lidhje me legjislacionin e referuar, në dokumentin që përfshihet te pjesa e llogaridhënies ne kemi analizuar ligjet kryesore në këtë drejtim, që janë: Kodi i Procedurave Administrative, ligji “Për bashkëqeverisjen”, ligji “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, ligji “Për vetëqeverisjen

vendore”, ligji “Për shërbimin civil”, i ndryshuar dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” në këndvështrim jo thjesht të një analize të përgjithshme, por edhe ku ka nevojë për ndërhyrje çfarë duhet të harmonizohet më tej.

Për efekt kohe jam ndalur vetëm në dy prej tyre: te ligji nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”, i cili konsiderohet në vetvete një risi në kuadër të llogaridhënies dhe vendimmarrjes gjithëpërfshirëse, sepse sipas këtij ligji veprimtaria administrative tashmë i nënshtrohet edhe kontrollit sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj. Kështu që, konsiderohet se mekanizmat që parashikon ky ligj do të bëjnë të mundur përmirësimin e bashkëqeverisjes, do të kontribuojnë në forcimin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga institucionet e administratës shtetërore, si dhe do të japin mundësi për një transparencë më të madhe. Në ndihmë të qytetarëve në këtë drejtim vjen edhe platforma “Me ty për Shqipërinë që duam”, e cila në javë mesatarisht trajton rreth 2000 ankesa nga qytetarët. Ligji tjetër është ligji “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, i cili, edhe në kuadër të politikës së Bashkimit European në këtë fushë, synon që, përmes zhvillimit rajonal dhe kohezionit, të inkurajojë rajonet më pak të zhvilluara për të përmirësuar gjendjen ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore përmes shfrytëzimit të potencialeve të rajoneve sa i përket kapitalit fizik dhe atij human.

Në lidhje me elementin e llogaridhënies, duke iu referuar raporteve të ndryshme, që ne i kemi pasur pjesë të metodologjisë, vlen të përmendim raportin e SIGMA-s (i fundit është ai i vitit 2021), i cili ka vlerësuar se në Shqipëri është krijuar një sistem kompleks i përgjegjësisë organizative dhe menaxhuese për të realizuar dhe zbatuar agjendën e reformës në administratën publike si në nivel politik, ashtu dhe në atë administrativ. Në krahasim me rajonin, ku flitet për llogaridhënien, me një mesatare 3 të zonës, Shqipëria mbetet një performuese solide rajonale në fushën e llogaridhënies.

Ajo që vlen të përmendet në këtë drejtim, siç e theksova, që për të përmirësuar kuadrin e strategjisë së reformës në administratën publike, pikë së pari, pritët të miratohen dy strategjitë e reja: strategjia për reformën në administratën publike dhe strategjia antikorruption.

Një element tjetër lidhet me riorganizimin e roleve dhe përgjegjësi brenda zyrës së Kryeministrit, një proces i cili ka vijuar, janë zhvilluar procese për të siguruar koordinimin e zhvillimit të politikave, veçanërisht për t’i harmonizuar ato me *acquis*-në e Bashkimit European, sidomos përmes rolit të SASPAK-ut. Megjithatë ende ka nevojë për përmirësim në kuadër të

koordinimit mes institucioneve, agjencive, ministrive dhe institucioneve të ndryshme të varësisë në këtë drejtim.

Në legjislacion ekziston një tipologji e organeve administrative, megjithatë ka diskutim sa i përket vlerës praktike të saj, sepse bëhet dallimi mes dy lloj institucionesh, ato të varësisë dhe agjencitë autonome. Kjo shpeshherë ka sjellë paqartësi në praktikë, ndaj, në vlerësimin e situatës në vend, siç theksohet nga Bashkimi Europian, kuadri ligjor për organizimin e administratës qendrore duhet të garantojë një bazë gjithëpërfshirëse dhe konsistente për krijimin dhe llogaridhënien e institucioneve në varësi dhe të agjencive autonome.

Vlen të përmendet që duhet të përmirësohet kuadri ligjor për sigurimin e llogaridhënies menaxheriale dhe të garantohet e drejta e qytetarëve për një administratë të mirë.

Në lidhje me disa gjetje dhe rekomandime sa i përket legjislacionit, ne e përmendëm që Kodi i Procedurës Administrative ofron kuadrin legjislativ në këtë drejtim, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ajo që nevojitet në këtë drejtim është të përfundojë procesi i harmonizimit të akteve nënligjore sektoriale me Kodin dhe pritet, edhe sipas udhërrëfyesit të reformës për administratën publike, që deri në dhjetor të vitit 2025, 65 akte të tilla sektoriale të harmonizohen me Kodin e Procedurës Administrative, për të sjellë lehtësi në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.

Sa i përket legjislacionit, krijimi i institucioneve të reja do të bëhet mbështetur në kritere të qarta lidhur me tipologjinë dhe legjislacionin e aplikueshëm. Në këtë drejtim merr rëndësi, si objektiv dhe rekomandim, amendimi i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i cili, sipas udhërrëfyesit, është paraparë të ndryshohet deri në dhjetor të vitit 2024, ndërsa legjislacioni dytësor, pra aktet nënligjore që do ta plotësojnë atë, deri në vitin 2025, për të garantuar nga pikëpamja ligjore dy elemente: së pari, krijimin e kuadrit efektiv të llogaridhënies për institucionet e varësisë dhe, së dyti, mirëpërcaktimin e tipologjisë së këtyre institucioneve të varësisë.

Një element tjetër lidhet me shërbimin civil, sigurisht ndryshimet e fundit ligjore në lidhje me reformën e pagave sollën ndryshime në strukturën e pagave të shërbimit civil, duke përfshirë një rritje të peshës së vjetërsisë në punë dhe një gamë më të gjerë të klasave të pagave. Gjithsesi, mbetet të adresohet më tej vlerësimi i performancës së nëpunësve, veçanërisht të nivelit menaxhues, dhe kompleksiteti i strukturës së pagave.

Një element tjetër që doja të përmendja, sepse llogaridhënia është e gjerë, ajo që kemi evidentuar në kuadër të mbikëqyrjes ka të bëjë me institucionet e pavarura që mbikëqyrin administratën publike, duke filluar nga institucionet kushtetuese, si: Avokati i Popullit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, por edhe institucione të tjera, një sërë komisionerësh, që monitorojnë veprimtarinë administrative për efekt të llogaridhënies.

Pikat e kontaktit në administratë janë përgjegjëse për mbështetjen e zbatimit të rekomandimeve të tyre, vetëm se është vënë re, pa dashur të kaloj te pjesa që Klesta përmendi për efekt të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave, që, duke marrë këto institucione kushtetuese të pavarura, ka nivel të ulët të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga këto institucione, që monitorojnë veprimtarinë administrative, duke referuar që niveli i tyre nuk e kalon më shumë masën 50% apo 40% për një institucion tjetër. Nga kjo pikëpamje, ndër të tjera, ajo që kemi evidentuar lidhet me rishikimin e pozicionit institucional të autoriteteve rregullatore që raportojnë në Kuvend, por edhe faktin që Kuvendi duhet të forcojë përpjekjet në mbështetjen e aktiviteteve të institucioneve të pavarura publike me rol mbikëqyrës, si: Avokati i Popullit, KLSH-ja, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Drejtave Personale, me qëllim përmirësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve nga këto institucioneve. Në kuadër të rekomandimeve nënvizohet përmirësimi i kuadrit rregullator për të përmirësuar planifikimin afatmesëm të politikave, për të zgjeruar përdorimin e vlerësimit të ndikimit rregullator në të gjithë legjislacionin dytësor dhe për të forcuar rolin e mbikëqyrjes parlamentare ndaj qeverisë, si pjesë e llogaridhënies.

Dua të them diçka shumë shkurt për pushtetin vendor.

Unë e përmenda arritjen në kuadër të ndryshimeve politike dhe institucionale, por edhe të dokumenteve strategjike, që lidhen me qeverisjen vendore, megjithatë e rëndësishme në këtë drejtim mbetet progresi i kufizuar sa i përket miratimit të legjislacionit zbatues, pra legjislacionit dytësor, që lidhet me ligjin “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, si dhe përpjekjet e mëtejshme për të angazhuar njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqatën në fazat e nismave legjislative, për të intensifikuar bashkëpunimin dhe koordinimin mes pushtetit vendor dhe atij qendror.

Veçojmë që, në kuadër të detyrimeve që kemi për efekt të procesit të anëtarësimit në Bashkimi Europian, vendi duhet të përgatitet për zbatimin më efektiv të *acquis*-ë së BE-së, sipas Kapitullit 22, dhe të përfshijë kërkesat e fondeve të ardhshme strukturore të kohezionit në strukturën institucionale, në sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe në kapacitetin

administrativ, për të garantuar që të gjitha instrumentet dhe fondet të bëhen gradualisht në përputhje me kërkesat e BE-së sa i takon programimit dhe parimeve të partneritetit.

Po ashtu duhet të vazhdohet më tej me strategjinë dhe Planin Kombëtar për Zhvillimin dhe Kohezionin Social, si dhe duhet të përfundojmë planet e zhvillimit rajonal, por, në të njëjtën kohë, merr rëndësi edhe përmirësimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore në nivel vendor, për të garantuar një administratë profesionale e të përgjegjshme, si dhe ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut, i cili duhet të përfshijë jo vetëm institucionet qendrore, por edhe ato vendore.

Ndërkohë, ne kemi paraqitur edhe tezat për diskutim publik:

Si mund të inkurajohet pjesëmarrja aktive e qytetarëve në proceset e qeverisjes dhe mbikëqyrjes së administratës publike, në kuadër të llogaridhënies? Si mund të bëhen më efektivë mekanizmat e bashkëqeverisjes? Si do ta vlerësonit nivelin e transparencës dhe standardeve të llogaridhënies së rregullatorëve sektorialë në ruajtjen e balancës mes konsumatorit, biznesit dhe qeverisë? A është kontrolli parlamentar dhe qeveritar në nivelin e duhur ndaj enteve rregullatore për veprimtarinë tyre? A sigurohet akses i nevojshëm i publikut në këtë vendimmarrje? Si mund të përmirësohet roli i DAP-it në lidhje me procesin e rekrutimeve të bazuara në meritë, integritet dhe paanësi politike?

Mbetem e hapur për pyetje dhe komente për efekt të prezantimit.

Ju faleminderit!

Eralda Methasani – Shumë faleminderit!

Ndjesë që ju nxisim për kohën, sepse me të vërtetë sot dëshirojmë që të jetë një tryezë e hapur diskutimi. Janë të pranishëm aktorë shumë të rëndësishëm të vendit në lidhje me elementin thelbësor për shtetin e së drejtës, që është llogaridhënia dhe transparenca, kështu që kalojmë në diskutim të hapur me pjesëmarrësit.

Dy shtyllat themelore janë transparenca dhe llogaridhënia.

Disa teza janë hedhur për diskutim publik. Duket që të dyja tezat në lidhje me të dyja shtyllat përqendrohen në këto elemente: si mund të rritet efektiviteti; si mund të forcohen mekanizma të ndryshëm institucionalë, administrativë për rritjen e efektivitetit në të dyja shtyllat dhe pastaj qasja e përgjithshme politike, strategjitë, çfarë mund të bëhet në lidhje me to, si dhe aspekte të detajuara të të dyja proceseve.

Fjala është e hapur për ju.

Adea Pirdeni – Përshëndetje!

Faleminderit për fjalën!

Do të doja ta nisja me një përgëzim për të dyja ekspertet që kanë punuar për të dyja fushat, sepse, nëse ka një fjalë që mundet realisht ta përfaqësojë siç duhet këtë pasqyrë të sotme, është jo vetëm qartësia, por, mbi të gjitha, kuptimi shumë i thellë i të gjitha problematikave dhe i të gjitha zotimeve që ka marrë Shqipëria në kuadër të procesit të negociatave, si në kuadër të Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike, por edhe Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, për disa seksione që kanë të bëjnë me llogaridhënien.

Kështu që, do të doja t'i falënderoja për të gjithë ekspozenë për të nxitur një debat publik edhe për çështje, të cilat shpesh duket sikur janë domen i ekzekutivit, por, në fakt, nuk i përkasin vetëm ekzekutivit, sepse përfshijnë të gjithë aktorët mbarëshoqërorë, organizatat e shoqërisë civile, me të cilat ne bashkëpunojmë ngushtësisht për çdolloj çështje që ka të bëjë me transparencën dhe llogaridhënien.

Dua ta nis në radhë të parë, sikurse ju e përmendët, me nevojën e domosdoshme që të gjitha këto përpjekje të enkapsulohen në një dokument të vetëm, sikurse është strategjia. Ne po punojmë përgjatë këtij viti në mënyrë intensive për ta finalizuar strategjinë për reformën në administratën publike. Arsyeja pse ky proces është shtyrë, është sepse qëllimi ynë ka qenë që në radhë të parë të bazohemi në këtë dokument, tek Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike, i dakordësuar me Komisionin Europian, më pas i dorëzuar në tetor të këtij viti edhe si një nga piketat hapëse për grup-kapitullin e parë të negociatave për Shqipërinë, një dokument i cili përbën edhe shtyllat tona kryesore të veprimit. Gjej me shumë vlerë faktin që jo vetëm në këtë pasqyrë janë trajtuar me detaje të gjitha elementet që janë pjesë e udhërrëfyesit, por do të jenë, gjithashtu, pjesë e detajuar me masa dhe aktivitete edhe në dokumentin e Strategjisë së Reformës në Administratën Publike.

Do të fokusohemi me radhë, në fillim të çështjet që kanë të bëjnë me transparencën dhe më pas me llogaridhënien. Transparenca ka një pozicion qendror në dokumentin e strategjisë, sidomos transparenca proaktive. Ne që nga qershori i këtij viti në një konferencë kombëtare, të bashkorganizuar me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kemi nisur një debat publik, një debat publik që më pas u shndërrua në një diskutim dhe dialog institucional. Përgjatë gjithë kësaj periudhe kohore jemi angazhuar me zyrën e Komisionerit për t'i përmirësuar të gjitha programet e transparencës së të gjitha ministrive të linjës. Sot për këdo që do të ketë interes, të gjitha këto programe janë në proces përmirësimi dhe zhvillimi. Natyrisht

që ka qenë një proces dhe informim i mëtijshëm me të gjitha strukturat tona, si me koordinatorët për të drejtën e informimit, por edhe me të gjithë aparatin administrativ.

Shpeshherë për ne duket sikur është e natyrshme që dihen dokumentet që janë miratuar ose i dimë se çfarë raportesh kanë dalë, duke filluar që nga raportet e brendshme deri te raportet e auditit, por, në fakt, të gjitha këto janë dhe duhet të jenë publike. Natyrisht, është detyrim i institucioneve të administratës publike, në bazë të ligjit “Për të drejtën e informimit”, që t’i bëjnë publike në formatin e programit të transparencës, që është një nga format e transparencës proaktive. Sigurisht që, në këtë drejtim, roli i koordinatorëve mbart rëndësi thelbësore. Përgjatë kësaj periudhe kohe kemi qenë çdo javë në kontakt me të gjithë koordinatorët e të drejtës së informimit, pikërisht për të angazhuar të gjitha ministritë dhe të gjitha strukturat ligjore, që ky procesi i transparencës proaktive të marrë rol qendror. Sot në të gjitha faqet e ministrive ka një rubrikë të veçantë që në faqen hyrëse për programin e transparencës, pra nuk ka nevojë që dikush të hyjë dhe të kërkojë në detaje që të gjejë se ku është programi i transparencës. Kjo kërkon më pas edhe një punë proaktive nga ana jonë që ne ta bëjmë këtë instrument më të dukshëm për të gjithë. Duket sikur është një pasqyrë e të gjitha dokumenteve tona që janë hedhur aty, por që jo domosdoshmërisht u flasin të gjithë qytetarëve.

Për sa i përket konsultimit publik, ne kemi nisur një iniciativë në kuadër të plotësimit të rekomandimeve të GRECO-s, sepse, sikurse e dini, shpeshherë në raportet ndërkombëtare, por edhe në diskutimet që kemi me aktorë të shoqërisë civile, diskutimi ka qenë se ne nuk informohemi kur dalin ligje, ne nuk informohemi kur publikohen në faqen e konsultimit publik aktet që janë në proces konsultimi. Çfarë bëjmë atë kohë? Angazhuam AKSHI-n në një iniciativë me të gjitha ministritë për të identifikuar të gjitha organizatat e shoqërisë civile aktive në fushat përkatëse, të cilat me vullnetin e tyre të lirë do të shpreheshin nëse do të kishin dëshirë të merrnin përditësime automatike për aktet që dalin në fushën e tyre. Supozojmë që, nëse dikush ka interes për të marrë informacione për akte që publikohen në fushën e mjedisit ose në fushën e bujqësisë, regjistrohet pranë portalit, i dërgohet një kërkesë për t’u regjistruar pranë portalit (kjo ka ndodhur) dhe këto njoftime vijnë automatikisht. Procesi i konsultimit publik ka afatet e tij dhe janë parashikuar shprehimisht në ligj, është 20 ditë pune. Kjo do të thotë që 20 ditë pune nuk janë pak, është një muaj kohë; do të thotë që për secilin nga ne kjo është një kohë, e cila mendohet e arsyeshme, me gjithë ngarkesën që ka, sepse kuptohet që edhe organizatat e shoqërisë civile nuk kanë fokus vetëm të angazhohen çdo ditë me faqen e konsultimit publik, por standardi 20-ditësh është tashmë një

standard i pranuar në të gjitha vendet e tjera, është një standard europian. Sigurisht, për akte me rëndësi të veçantë natyrisht që procesi mundet të shtrihet përtej këtij afati 20-ditor, dhe ne kemi parë që ka pasur një përmirësim të ndjeshëm. Ajo çfarë e bën më kuptimplotë këtë proces, edhe nga përvoja jonë me strategjitë, me projektligjet, është që, tej konsultimit publik në platformë, e cila inkurajohet si mjeti më i rëndësishëm, për ne kanë qenë me shumë përfitim nga ana cilësore për procesin e ligjbërjes, takimet që kemi pasur dhe fakti që shpeshherë në çdo koment që ka ardhur, kemi kthyer përgjigje me *e-mail*: ky është komenti që ka ardhur nga ju, është reflektuar, nuk është reflektuar, këto janë arsyt pse nuk janë reflektuar, nëse nuk është reflektuar. Të them të drejtën, besoj se kjo ka qenë një nga mënyrat e vetme që mund të mbahet gjallë ky lloj diskutimi, sepse, nëse dikush dërgon një koment dhe komenti nuk merret në konsideratë, nuk jepet arsyeja, ky është një problem dhe shpeshherë ndodh me institucionet e administratës, nuk është fenomen që nuk ndodh.

Për sa i përket shtyllës së dytë, llogaridhënies, ne kemi nisur një proces rishikimi të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, është një proces, i cili ka nisur së bashku me projektin “*EU for Good Governance*”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm 2 minuta.

Po flas për të dyja çështjet, kështu që besoj se mund të më lejohen 2 minuta më shumë.

Eralda Methasani – Dëshironi më mirë të trajtojmë çështjen e parë, pastaj të dytën?

Faleminderit, sepse jemi më të përqendruar!

Xheni Dimraj – Përhëndetje, faleminderit Kuvendit për mundësinë për të marrë pjesë sot!

Unë quhem Xheni Dimraj, përfaqësoj Federatën Shqiptare të Sportit Shkollor. Aktualisht dua të ndaj me ju shqetësimin që kam ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, e cila nuk ka respektuar kuadrin ligjor për sa i përket ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, të ndryshuar me ligjin nr. 105/2020. Në nenin 6 të këtij ligji përcaktohen detyrat e Federatës së Sportit Shkollor dhe të Federatës së Sportit Universitar. Gjithashtu, dua të shpreh shqetësimin ndaj ministrisë për moszbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Federatës së Sportit Shkollor.

Së fundi, nëpërmjet Kuvendit, duke e falënderuar përsëri Kuvendin për transparencën dhe gjithëpërfshirjen, jemi njohur me projektligjin “Për sportin” dhe propozimet që janë bërë për

ndryshimin e këtij projektligji. Kemi vënë re me shqetësim se në hartimin e projektligjit “Për sportin” dhe në relacionin shoqërues nuk përmenden dhe nuk janë marrë parasysh dispozitat e Kartës Europiane të Sportit apo rekomandimet e fundit të EPA-s.

Gjithashtu, dua të ndaj me ju edhe një shqetësim tjetër, ne kemi tre vjet që nuk financohemi nga ministria, as nuk na hapet dera për transparencë dhe për të diskutuar, pavarësisht se ligji na jep detyra shkencore për t’i zbatuar për sportin në Shqipëri.

Faleminderit!

Eralda Methasani – Ju falënderojmë!

Në fakt, unë do të doja shumë që diskutimin ta mbanim te shqetësimet dhe sugjerimet për të përmirësuar transparencën. Fakti që ju referoni që keni parë projektligjin dhe keni komente për të, është gjetje e mirë, sepse tregon se procesi funksionon.

Xheni Dimraj – Po, një tjetër shqetësim që do të doja ta ndaja me ju është mungesa e transparencës në faqen e Ministrisë së Arsimit. Aktualisht në faqen e Ministrisë e Arsimit nuk gjendet financimi i madh që i është bërë KOKSH-it së fundi dhe vlerat. Kështu që, mendoj se edhe kjo është një tjetër çështje që duhet përmirësuar.

Faleminderit!

Eralda Methasani – Pra, programet e transparencës kanë nevojë të përforcohen edhe më shumë.

Fjala për zotin Shella.

Gerti Shella – Faleminderit!

Ju përshëndes të gjithëve!

Unë jam Gerti Shella, përfaqësoj Qendrën për Çështjet e Informimit Publik apo, siç njihet, *INFOCIP*.

Përgëzoj relatuesin dhe grupin e punës që kanë punuar në dy komponentë shumë të rëndësishëm, që janë: mirëqeverisja dhe transparenca, si dhe llogaridhënia që implikon, gjithashtu, në mënyrë substanciale çështjet e mirëqeverisjes.

I gjeta jashtëzakonisht të peshuara mirë, pra të vlerësuara në miratimet dhe kundërshtimet e tyre, sidomos argumentet për mirëqeverisjen, që duket si një refren që përsëritet, në mos gaboj, në 4-5 progresraportet e fundit, që kanë të bëjnë me konsultimin publik. Konsultimi publik nuk është thjesht vitrina, por edhe lakmuesi, pra aty ku testohet vullneti i mirë i atyre që qeverisin dhe i atyre që qeverisen.

Shqipëria për këtë ka një ligj, do të thosha modest, nuk besoj se futet te ligjet më të mira, edhe pse ka vetëm një javë diferencë nga procesi i miratimit të ligjit “Për të drejtën në informimit”.

Në vlerësimin tim ky ligj duhet parë me prioritet, edhe për të adresuar ato që tashmë janë kritika të konsoliduara të partnerëve tanë, sidomos të Bashkimit Europian, të cilët kritikën e tyre ose ndoshta pakënaqësinë në këtë fazë, mund ta përdorja lehtësisht edhe këtë fjalë, e përmbledhin në konceptin “konsultime jodomethënëse”, pra konsultime formale, e përkthyer në një version, i cili mendoj se, me disa ndryshime të thjeshta të ligjit ekzistues, mund ta pozicionojë Shqipërinë njësoj siç e pozicionon ligji “Për të drejtën e informimit” ndër 10 vendet me kuadër ligjor të avancuar, krahasimisht me shumë vende të OECD-së, pse jo edhe krahasimisht me vendet e botës, ndër ato vende ku realisht i jepet rëndësi rindërtimit në mënyrë demokratike, pra brenda një matrice me lojë, që bëhet me përfitim dhe jo me humbje, ndërmjet atyre që qeverisin dhe atyre që qeverisen. Për shembull: cilat mund të jenë dy-tri ndërhyrje që unë mendoj, zonja Hysi, se mund të jenë pjesë e relacionin që ju do të hartoni?

Ligji “Për konsultimin publik” parashikon një instrument të rëndësishëm, i cili rezonon me strategjinë qeveritare për shërbimet elektronike, regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike. Vetëm për një harresë, do të thosha, të parëndësishme, të pafajshme, 61 njësitë e qeverisjes vendore nuk listohen ndër ato institucione, të cilat platforma ekzistuese do t’i lejonte që të ndërmerrnin hapat që ligji parashikon për njoftimin, konsultimin, dokumentimin, pse jo arsyetimin e refuzimit, siç e tha me drejtë zonja ministre, që është një hallkë e munguar e të gjithë procesit dhe që nuk i shton, përkundrazi i heq seriozitetin edhe angazhimeve të marra nga Kuvendi fillimisht, sepse besoj se vullneti Kuvendit në fillim të herës ka qenë që Shqipëria të avancojë proceset në llogaridhënie përmes informimit publik dhe në një llogaridhënie aktive ose një bashkëqeverisje përmes procesit të konsultimit.

Gjithashtu, roli mbikëqyrës është i munguar në legjislacionin tonë për konsultimin publik. Pra, ne kemi një institucion mbikëqyrës për të drejtën e informimit, që është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, por nuk kemi një institucion të kësaj përmase ose të kësaj stature sa i takon ligjit “Për konsultimin publik”. Gjithashtu, koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik, për mendimin tim dhe në vlerësimet që ne në mënyrë aktive kemi bërë në programet tona, në bashkëpunim me UNDP-në dhe me qeverinë shqiptare, ka një rol profesionalisht më sfidues sesa koordinatori për të drejtën e informimit, sepse kalendarët e konsultimit publike do të duhet t’i zbatojnë. Pra, ata praktikisht vënë në zbatim operacione ose

veprimtari me pjesëmarrje masive. Kjo nuk është një fjalë goje, nuk mund të jetë ky një funksion i tretë apo i dytë, që i qepet një funksionari në nivel qendror apo në nivel vendor, që unë e shikoj më problematik.

Sa i takon regjistrin vendor ose regjistrin të njoftimit të akteve, që është i munguar në nivel vendor, kjo punë mund të zgjidhet që tani, pra brenda ditës, sepse në bashkëpunim me qeverinë shqiptare, UNDP-në, Agjencinë për Mbikëqyrjen e Qeverisjes Vendore, është ndërtuar një platformë “konsultimi vendor.al”, që është pilotuar në 7 bashki, 2 të mëdha, 2 të mesme dhe 3 të vogla, dhe sistemi funksionon. Pra, thjesht duhet vullneti që qeveria shqiptare, me mjetet që ajo disponon, ta kooptojë kundrejt asnjë detyrimi në këtë rast, meqenëse është pothuajse një gjë e paguar, dhe ne mbyllim në këtë mënyrë, pra kompletojmë sistemin tonë, mjetin kryesor të implementimit të konsultimit vendor, që është regjistri i konsultimit të akteve, dhe ndoshta, në kuadër të agjendës së komisionit, futja në procesin legjislativ për ndryshime dhe përmirësime të ligjit “Për konsultimin publik”, besoj se nuk duhet të ketë kundërshti nga asnjëra prej palëve, pse jo politike, do të thosha, të përfshira në ndërveprim me njëra-tjetrën.

Meqenëse jemi te mirëqeverisja, unë do dua të përfitoj nga rasti që të ngre një pretendim ose të depozitoj një kërkesë, ta ridepozitoj më saktë, pasi në proceset e mirëqeverisjes dhe të llogaridhënies Republika e Shqipërisë, për arsye që nuk do të ndalem t’i diskutoj, mbart sot, në vitin 2024, hallkën e munguar të proceseve referendare.

Referendumi është një proces kushtetues dhe Kushtetuta në vitin 1997, kur u miratua, la një diapazon 3-vjeçar, më pas 4-vjeçar, që të plotësohej kuadri ligjor. Është rezervë ekskluzive e Kuvendit të Shqipërisë, e parashikuar në nenin 81 të Kushtetutës, avancimi i procesit legjislativ për disa ligje të veçanta, ku hyn edhe ligji “Për referendumet”. Para katër vjetësh ne menduam që ligji ishte sfidues, sepse, duke qenë material dhe procedural, mund të konsumonte resurset e Kuvendit dhe me resurset tona në sektorin e shoqërisë civile, ku grupuam organizatat më të rëndësishme të vendit, draftuam një ligj shumë dinjitoz, që adresonte çështjen e referendumit në nivel qendror dhe hallkën e munguar të referendumit në nivel vendor, që e parashikon jo thjesht Kushtetuta, por edhe ligji kuadër “Për qeverisjen vendore”.

Eralda Methasani – Gerti, ju lutem, kaloni te sugjerimi konkret.

Gerti Shella – Atëherë, po kaloj te sugjerimet.

Unë do të sugjeroja përmirësime, plus ndryshime të ligjit “Për konsultimin publik” dhe do ta ftoj Kuvendin të konsideronte edhe detyrën kushtetuese për t’i dhënë Shqipërisë një ligj kuadër

“Për referendumet” dhe le të jetë Kuvendi, me angazhimet e marra në kuadër të komisionit “Xhafaj”, që ia plotëson këtë dimension të munguar demokratik Republikës sonë.

Mund të limitohem në dy komente që kisha për llogaridhënien, por mund edhe ta lë të hapur diskutimin, ndaj ju falënderoj për mundësinë që më dhatë!

Eralda Methasani – Shumë faleminderit!

Atëherë, radha është kjo: zonja Hoxha...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, dëshironi të ndërhyini?

Juljana Hoxha – Po, shumë shkurt.

I bashkohem korit të kolegëve në këtë sallë, duke përgëzuar dy ekspertet për punën. Në fakt, është një panoramë dhe analizë gjithëpërfshirëse, kështu që shumë urime dhe faleminderit!

Dua të them dy-tri gjëra shumë shkurt. Një ndër gjërat që kisha, ishte që përmendi edhe Gerti për sa u përket referendumeve lokale, ku shoqëria civile ka disa vite që advokon për këtë çështje. Gerti është një prej liderëve në këtë fushë. Pra, ka një punë të bërë, janë të paktën dy drafte për referendume lokale. Unë mendoj, meqenëse baza ekziston, se kjo është një çështje që duhet konsideruar.

Për sa i përket pjesës së transparencës dhe gjithëpërfshirjes, një nga gjërat që është adresuar në analizë, që mendoj se është e rëndësishme, ka të bëjë me pjesën e zgjerimit të optikës së ligjit “Për konsultimin publik” me përfshirjen e vendimeve të qeverisë. Kjo gjë, shumë drejt dhe korrekt, adresohet edhe në raport. Gjëja që vihet re, ky është shqetësimi kryesor, të cilin ka disa vite që e ngremë, është se sa më shumë që kalon koha aq më shumë çështje delikate të kuadrit ligjor trajtohen me vendime qeverie. Meqenëse, këto janë dokumente zyrtare nuk janë pjesë e ligjit, mendoj se përbën një mangësi shumë të rëndësishme për sa i përket gjithëpërfshirjes.

Pjesa e konsultimit publik

Zonja Pirdeni e tha me shumë të drejtë, pra, nëse duhet ta stimulojmë gjithëpërfshirjen, një ndër elementet kryesore është konsiderata, pra marrja parasysh e opinionit. Nëse ka diçka që është konsistente në të gjithë ata që raportojnë, përfshirë edhe partnerët në Shqipëri, prej disa vitesh në këtë drejtim është ekzaktësisht ky element.

Në momentin ku jemi pasojë më e dukshme ka të bëjë me mospjesëmarrjen. Platforma e integritetit europian është një ndër treguesit për përfshirjen e ulët të shoqërisë civile në këtë drejtim. Ndaj, një ndër elementet ka të bëjë edhe me pjesën e marrjes në konsideratë.

Zonja ministre tha se sot dhënia e llogarisë nga ana e institucioneve është e argumentuar, për opinionet që merren nga publiku pro apo kundër, por, në fakt, duhet të them se eksperiencia jonë nuk është e tillë. Unë po flas edhe për sektorin, meqenëse bëjmë një vlerësim vjetor, por po flas edhe në emër të partnerëve, në vetë të parë, që nuk ka qenë kjo eksperiencia jonë. Pa u hyrë detajeve, por nëse ka një debat të nxehtë për momentin, për sektorin, është ai që ka të bëjë me rimbursimin e TVSH-së...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, pa hyrë në detaje. Ky është një diskutim, i cili nuk ka marrë përgjigje nga institucionet deri tani.

Dua të bëj një kujtesë, nuk ka të bëjë me këto dy tema, për sa i përket qëllimit të këtij komisioni. Unë i kam lexuar me shumë vëmendje raportet e nxjerra dhe meqenëse pjesë e *scope*-t janë edhe tri *roadmap*-et që kanë të bëjnë me klasterin 1, dua t'ju sjell në vëmendje se, kur bëhet fjalë për *roadmap*-in për institucionet demokratike, unë jam pjesë e sektorit dhe këtu një pjesë e madhe e përfaqësuesve janë nga sektori, dua t'ju them se ka edhe disa detyra, për sa i përket kuadrit ligjor mundësues për vetë sektorin, të cilat nuk i kam parë të adresuara në raport.

Nëse flasim për pjesëmarrës, pra për gjithëpërfshirje, duhet të ekzistojë ky mjedis mundësues për sektorin, i cili është pjesë e *roadmap*-it. Këtë e sjell me shumë shqetësim, sepse në një shkëmbim të fundit me DG NEAR, duket sikur, kur flitet për integrimin europian dhe për *roadmap*-et, flitet vetëm për detyrat e institucioneve shtetërore, qeveri – parlament, por meqenëse nuk janë pjesë e *chapter*-ave, shoqëria civile trajtohet si pjesë e këtij *roadmap*-i, që është po aq detyrues sa dhe *chapter*-at individual.

Faleminderit!

Eralda Methasani – Faleminderit, zonja Hoxha!

Do të vijoj me radhën, por zoti Elezi e kërkoi fjalën.

Zoti Elezi, dëshironi të thoni diçka?

Ermal Elezi – Faleminderit!

Do të flas shumë shkurt.

E para, për sa kohë shoh që bashkitë nuk janë të përfaqësuara në nivele të tjera, pra nuk ka përfaqësues të tjerë përveç shoqatës....

Ne bëjmë një vlerësim të vazhdueshëm e periodik dhe jo më larg se 3 javë më parë kemi publikuar një raport për performacën. Po, ka nevojë të përmirësohet transparenca, por nuk duhet

të dalë sikur është diçka që bashkitë nuk kryejnë transparencë, nuk kryejnë konsultime, sepse ka njerëz këtu në këtë tryezë që e dinë shumë mirë që kjo gjë ndodh, madje për buxhetin ndodh disa herë me grupe të ndryshme. Të gjitha bashkitë kanë faqe *web*-i, ku i publikojnë aktet. Ndoshta jo të gjitha bashkitë i publikojnë me të njëjtën korrektësi të gjitha aktet, por përsëri është një praktikë që ekziston.

U përmend rasti i sistemit. Unë kam dëgjuar për shumë sisteme. Të më falni, por, po e them pa asnjëfarë diplomacie, se këto janë sisteme që nuk zhvillohen në shtetin shqiptar. Një gjë që bëhet jashtë shtetit, nuk mund të përdoret nga shteti shqiptar. Kjo ka ndodhur me të gjitha sistemet që ka bërë UNDP-ia me STAR 3.

Ky sistem që ju i referoheni, që është zhvilluar nga ju, nuk është marrë në dorëzim as nga AKSHI dhe as nga përfituesi, që është Ministria e Brendshme.

Ne bashkitë mund t'i orientojmë, por falë autonomisë që ato gëzojnë, as i detyrojmë dhe as i nxisim dot, që t'u themi të përdorin këtë platformë.

Këtu nuk është zonja Zana Vokopola, por edhe ajo ka bërë një sistem për këtë gjë, ndoshta duhet të përdornim atë sistem.

Unë mendoj se sistemin duhet ta bëjë shteti shqiptar. Nëse duhen përqendruar 61 aktet, atëherë kjo duhet të jetë përgjegjësi e shtetit shqiptar, nëpërmjet AKSHI-t. Çështja e sistemeve ka prani vulnerabiliteti ndaj sulmeve kibernetike. Pra, ne nuk mund të futemi nëpërmjet *domain*-ve të bashkive në rrjete dhe sisteme që nuk i kemi të autorizuar.

Eralda Methasani – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, vazhdoni.

Ermal Elezi – Unë dua t'i mbroj bashkitë, se për pjesën tjetër e mora vesh.

Ne kemi edhe raportime mbi planet e integritetit, se nuk është vetëm çështja hartimit të planeve të integritetit.

Falë Bashkimit European, këtu kemi edhe përfaqësues të monitorimit të planit të integritetit, bashkitë kanë realizuar 58% të planeve të integritetit pra, mbi gjysmat. Këtë e kanë realizuar në mënyrë konsistente dhe për këtë marrin një financim si premium nga buxheti.

Ndërsa për çështjet e tjera që u adresuan unë bie dakord që duhet t'i adresojmë.

Për sa i përket konsultimit, ka një organ që quhet “Këshilli Konsultativ”. Në Këshillin Konsultativ ka përfaqësues nga qeveria qendrore dhe nga të gjitha bashkitë, por ftohen edhe aktorët

kryesorë të NGO-ve. Mbase pjesëmarrja duhet zgjeruar, pra të ftojme edhe aktorë të tjerë, sepse Këshilli Konsultativ është i hapur dhe nuk ka ndonjë problem për sa u përket akteve për konsultim.

Ne me projektin *Youth For Good Governance* po përpiqemi të kemi proaktivitet nga bashkitë për propozime, jo vetëm të akteve të karakterit normues në nivel kombëtar, por edhe në nivelit rajonal, duke bashkuar disa bashki në iniciativë.

Faleminderit!

Eralda Methasani – Faleminderit!

Fjala është për zotin Vurmo. Më pas fjalën e ka zonja Dhuka dhe zoti Dervishi.

Gjergji Vurmo – Faleminderit!

Më lejoni të bëj edhe unë komplimentet e mia për punën e dy grupeve të punës, për të dyja dokumentet. Ne mund t'i ndajmë, por një pjesë e komenteve janë shumë të lidhura me njëra-tjetrën, ndaj do të më duhet të shtrihem edhe te dokumenti i dytë. Por, po flas për dokumentin e parë, “Transparenca dhe informimi”.

Një nga çështjet që kemi ngritur dhe kemi diskutuar edhe me zotin Xhafaj ka qenë çështja e prioritarizimit të problematikave ose sfidave, që ky komision do të marrë përsipër për t'i adresuar. Unë mendoj se komisioni që në krye të herës, pra që me krijimin e vet, e ka ngritur stekën shumë lart. Në këtë kuptim, pavarësisht se problematika e skanuar në kuadër të informimit dhe transparencës është shumë e plotë, dhe për këtë nuk kam objeksione, mendoj se një pjesë e mirë e tyre nuk janë çështje që duhet të futen në agjendën e këtij komisioni, si rekomandime të tipit: ka nevojë për monitorim strategjik apo kemi nevojë për ndërgjegjësim, apo për kapacitetet të tjera, kjo është një pjesë rutinore e zbatimit të reformave më shumë sesa e konceptimit të tyre, sidomos reformat që marrin përsipër të bëjnë thellim të mëtejshëm të ndikimit që ka pasur një ndërhyrje e mëparshme, para 10 vjetësh, e cila, në fakt, është ende në zbatim.

Megjithatë, për të drejtën e informimit dhe për konsultimin publik kolegët i mbuluan të gjitha çështjet. Unë do të thosha që, duke pasur parasysh nevojën për të prioritzuar pak çështjet që mund t'i sjellim në vëmendje këtij komisioni, përveç atyre çka u rekomanduan, do të sillja në vëmendje pjesën e draftimit të projektligjeve, por edhe të VKM-ve. Pra, përveç nevojës për të përfshirë edhe vendimet e Këshillit të Ministrave në pjesën e konsultimit publik, mendoj që duhet parë me shumë kujdes edhe pjesa e draftimit të ligjeve. Ka një manual shumë të mirë, të hartuar nga EURALUS-i, për mënyrën se si duhen draftuar ligjet, por që nuk reflektohet fare në rregulloren e Këshillit të Ministrave. Rregullorja e Këshillit të Ministrave, për shembull, nëse e shohim, ka të

elauburuar vetëm një parim të procesit të ligjbërjes, është parimi i konfidencialitetit, ndërkohë që procesi i ligjbërjes, pra draftimi i ligjeve, duhet të udhëhiqet edhe nga parimi i transparencës, edhe parimi i mënjanimit të konfliktit të interesit, edhe nga parimi i profesionalizmit, edhe nga parimi i gjithëpërfshirjes. Kështu që, mendoj se ka një hapësirë, e cila mund të merret në konsideratë nga ky komision.

Së dyti, në lidhje me konsultimin publik në nivel vendor, përveç vendimeve të këshillave bashkiakë, qytetarët afetkohen direkt nga projektet e mëdha, qoftë infrastrukturore, qoftë turistike, qoftë mjedisore, pra të të gjitha fushave. Dhe, për fat të keq, pikërisht për të gjitha këto projekte të ndërmarra nga pushteti vendor apo edhe ai qendror, qytetarët dhe komunitet vendore nuk konsultohen mjaftueshëm, për të mos thënë që nuk konsultohen fare dhe vendosen para faktit të kryer. Këtu ka hapësirë edhe për ta rregulluar procesin, për ta bërë të detyrueshëm, por ka hapësirë edhe për të ndërhyrë qoftë në kompetencat e institucioneve përkatëse, qoftë në procese të ndryshme.

Një tjetër element ose një tjetër instrument që Kushtetuta dhe ligji na kanë dhënë ne si qytetarë janë edhe nismat ligjore qytetare. Edhe kjo është një e drejtë apo një instrument tjetër që nuk funksion. Mendoj se duhet parë se cilat janë barrierat në këtë kontekst.

Në lidhje me llogaridhënien kam përshtypjen se ka një konfuzion, që mund të jetë tek termat e referencës, sepse unë i kam lexuar të dyja dokumentet me shumë vëmendje, por kam lexuar edhe përshkrimin e dokumenteve, titulli flet për llogaridhënien e administratës publike, ndërkohë përmbajtja flet edhe për llogaridhënien e administratës publike, por edhe për llogaridhëniet që shtrihen përtej administratës publike, pra llogaridhëniet e institucioneve, llogaridhëniet e drejtuesve të institucioneve ose mënyra se si janë rregulluar marrëdhëniet, në kuptimin e kontrollit dhe balancës midis institucioneve, flitet edhe për llogaridhëniet e Kuvendit ose llogaridhënie që siguron Kuvendi ndaj pushteteve të tjera. Mendoj se këtu mund të ndahet pak, ka hapësirë për të punuar edhe për administratën publike, por sërish mendoj se çështje të tjera janë më shumë të nevojshme për t'u përfshirë në fokusin e komisionit. Le të marrim shembull mjekësinë, arsimin, policinë ushtrinë. Hajdeni të flasim për këto, sepse këto janë armata të punësuarish, të cilat ndër vite janë keqpërdorur tradicionalisht nga të dyja krahët apo të tria krahët (nuk e di sa krahë ka politika dhe sa ka pasur në këta 30 vjet), si për punësime elektorale, si për vota. Në fund të ditës jemi ne që marrim shërbimet e tyre, qoftë në shëndetësi, qoftë në arsim,

qoftë në siguri nga ana e policisë, të cilat janë të cingura, janë me një cilësi shumë të dobët dhe në fund përfundojmë edhe me tragjedi, siç po i dëgjojmë ditët dhe muajt e fundit.

Sa i përket zhvillimi rajonal dhe ndërmarrjet publike, më vjen shumë mirë që janë prekur, sidomos ndërmarrjet publike, sepse janë një plagë e madhe, janë një gropë e madhe financiare dhe keqpërdorimesh, është shumë e nevojshme që të shihen më me vëmendje. Por, kur flasim për zhvillimin rajonal, kohezionin apo fondet që duam të marrim, nuk duhet të lëmë jashtë vëmendjes edhe çfarë ka ndodhur. Shqipëria është i vetmi vend, të cilit i janë ndërprerë fondet IPA, sigurisht unë jam shoqëri civile dhe dua t'i them gjërat dhe emrat edhe kur nuk është nevoja mbase, por minimalisht dokumenti apo puna e grupit të punës të mundohet të kuptojë se çfarë ndodhi, sepse nuk ishte administrata publike ajo që vodhi fondet apo edhe në fushat e tjera. Të jemi të sigurt për këtë, nuk guxon asnjë nëpunës të ndërtojë skema të tilla “5 D”-ra e “5 P”-ra, e ku di unë e “3 D”-ra. Kështu që, të mos i biem në qafë administratës publike, por ta vëmë gishtin aty ku duhet dhe të shohim aty ku duhet si është puna.

Eralda Methasani – Faleminderit!

Zonja Dhuka.

Majlinda Dhuka – Faleminderit!

Përshëndetje!

Përgëzime kolegeve të Universitetit të Tiranës!

Falënderime për zotin Xhafaj dhe deputetët, që krijuan këtë platformë dialogu midis institucioneve, faktorëve shoqërorë dhe partnerëve!

Unë, në fakt, duke mbajtur në vëmendje çështjen e prioritizimit, atë që tha zoti Vurmo, do të doja të sillja në fokus disa çështje, të cilat mendoj se duhen konsideruar, së paku në fazën e analizës, që lidhen me momentin në të cilin ky komision dhe grupi i ekspertëve e kryen aktivitetin e vet, është çasti kur Shqipëria sapo ka çelur negociatat dhe perspektiva e anëtarësimit besohet se do të jetë e afërt. Në këtë kuptim, ne duhet të reflektojmë përmirësimet që duhet të bëjmë në kushtet e rrugës së negociimit dhe të anëtarësimit.

Më konkretisht, këtu u fol në lidhje me konsultimin e akteve nënligjore, ide të cilën e mbështes plotësisht, por duhet të mbajmë në konsideratë që ndoshta duhet të analizojmë edhe nevojën për vlerësimin e ndikimit rregullator të politikave.

Bashkimi European punon mbi bazë politikash: politika e kohezionit, politika e përbashkët bujqësore e të tjera. Trupa e *acutis*-ë përbëhet përgjithësisht nga direktivat dhe rregulloret.

Rregulloret janë të vetëzbatueshme, por direktivat janë kryesisht udhëzime të politikave. Në këtë kuptim, është e nevojshme të shohim nevojën për vlerësimin e ndikimit të politikave përpara marrjes së nismave ligjore ose politikëbërëse, ka të bëjë drejtpërdrejt me ndikimin në grupet e interesit të një politike, ndikim pozitiv ose të nevojës për axhustime dhe përshtatje.

Unë mendoj se ky duhet të jetë një ndryshim i rëndësishëm në çastin në të cilin ndodhemi. Vetëm për efekt shembulli po marr politikën e përbashkët bujqësore, ka rëndësi që të bëhet një reflektim i gjerë ekonomik, shoqëror jo vetëm në institucionet publike, në lidhje me ndikimet e pritshme të politikës së përbashkët bujqësore në bujqësinë shqiptare, përmirësimet cilësore, por edhe transformimet e nevojshme. Sigurisht, grupet e interesit dhe shoqëria civile këtu luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm, sepse ky vlerësim duhet të vijë nga poshtë lart, me qëllim që të jetë realist, por edhe të ndikojë ndryshimin dhe transformimin në themel. Të mos bëjmë gjëra në letër, të cilat nuk janë të qarta si do të ndikojnë, në fakt, dhe pa e përgatitur faktorin ekonomik dhe shoqëror mbi si do të ndikojnë ato. Prandaj, unë mendoj që ky është hap i domosdoshëm në momentin në të cilin ndodhemi.

Në lidhje me konsultimin, sigurisht, ka disa përmirësime të nevojshme, si regjistri i konsultimit, dimensionin lokal e të tilla si këto, që janë të mirëpritura, janë rregullime të brendshme, të cilat unë i mbështes plotësisht. Ne kemi parë modelet e forumeve opiniondhënëse dhe influencuese në Bashkimin Europian. Një model i tillë është Këshilli Social Ekonomik Europian, për shembull, por sigurisht ai është supernacional. Ne kemi parë për momentin edhe një model nacional, atë të Francës. Franca shquhet për një dialog social me shumë traditë. Ekzistojnë forume opiniondhënëse. Pra, çështja nuk ngelet te qeveria ose tek institucionet publike, të cilat shpallin për konsultim një nismë. Ekzistojnë forume opiniondhënëse të cilat përbëhen nga konstituencat e të gjitha grupeve të interesit dhe të shoqërisë civile, me deri në 300 anëtarë, me mandat, me sekretariat, me fond të dedikuar që ka mundësi të bëjë analiza, të cilat kanë funksione të përhershme. Pra, shoqëria civile ulet në një forum përfaqësimi, roli i të cilit është vetëm dhënia e opinionëve. Janë të rregulluara edhe rastet kur jepen opinionet në mënyrë të detyrueshme, e shpall ose nuk e shpall institucioni publik, në kuptimin e ngushtë të fjalës, dhe është krijuar edhe mbështetja për analiza, sepse vetë cilësia e komenteve ka rëndësi. Unë mendoj se, sa i përket dhënies së opinionëve mbi ndryshimin shoqëror dhe ekonomik, jo vetëm konsultimit publik dhe njëkohësisht influencimit, të cilin e kanë rol të rëndësishëm shoqëria civile, grupet e interesit, *think tank*-u, ndoshta duhet të diskutojmë një organizim tjetër më përfaqësues, duke mbështetur edhe

mundësinë e analizave të pavarura, të cilat pastaj trupëzohen në rekomandime dhe opinione që i shkojnë faktorit politikëbërës publik, por edhe shoqërisë, si agjentë të ndërmjetëm të transformimit, rol të cilin e luajnë shoqëria civile dhe grupet e interesit. Gjithsesi, nuk them se ky është një vendim të cilin duhet ta marrim tani, por duhet ta diskutojmë.

Çështja tjetër që dua të ngre ka të bëjë me informimin. Ne duhet të fillojmë të zgjerojmë gjerë informimin në lidhje me Bashkimin European. Qytetarëve, bizneseve, institucioneve po ashtu, do t'u lindin të drejta e detyrime në kuadrin e të qenit një vend anëtar në Bashkimin European. Ne kemi disa mjete të cilat i përdorim sot, siç janë këndet e Bashkimit European në bashki, që janë më afër qytetarëve, kemi Shtëpinë e Biznesit, një nismë e re e cila mund të shërbejë si një hap gravitacional për të informuar biznesin, sigurisht edhe programet e transparencës. Po shohim edhe mundësinë e ndërtimit të asistentëve virtualë për qytetarët, me pyetje të ndeshura shpesh në lidhje me Bashkimin European për bizneset dhe për institucionet, por unë mendoj se duhet të thellohem e të diskutojmë nëse janë të mjaftueshme mjetet që kemi apo duhet të zhvillojmë mjete të reja. Informimi në lidhje me të drejtat e detyrimet e Bashkimit European ka rëndësi, së paku, për dy çështje. Së pari, ka rëndësi në lidhje me mjetet e garantimit të të drejtave, sepse qytetarët shqiptarë, teksa bëhen qytetarë të Bashkimit European, do të kenë mjete të garantimit edhe në nivel nacional, edhe në nivel european. Së dyti, ka të bëjë me atë që njihet si *infringement*...

Eralda Methasani – Ju lutem, kemi pak merak kohën sot!

Malinda Dhuka – Po.

Çështja e fundit që mendoj se duhet të diskutojmë sot, për të cilën ky komision është një praktikë shumë e mirë, ka të bëjë me mekanizmat e koordinimit në nivelin qendror, midis nivelit qendror dhe atij vendor, njëkohësisht, edhe me institucionet e pavarura, por edhe të publikut me faktorin shoqëror, pra të institucioneve publike me faktorin shoqëror, kjo sepse kemi nevojë të bëjmë disa zhvillime në këtë drejtim.

Së pari, janë të ashtuquajturat “kompromise”. Bashkimi European i ka këto praktika, të cilat njihen si “*compromis*”. Janë kompromiset që arrihen në lidhje me politika të caktuara të rëndësishme midis institucioneve publike, në disa raste edhe institucioneve publike, edhe Këshillit Ekonomik Social, që është asambleja e shoqërisë civile. Le ta themi kështu në vija të thjeshta.

Së dyti, siç e shpjegova edhe një herë, është mekanizmi për të rritur maturitetin e zbatimit, sepse për t'u bërë vend anëtar kërkohet zbatimi, me qëllim që të mos shkojmë në shkelje për zbatimin.

Pra, mendoj se ne duhet të zhvillohemi në mendimin tonë, në rrugën drejt anëtarësimit dhe të bëjmë disa përmirësime të cilat janë të nevojshme për këtë ndryshim.

Faleminderit!

Eralda Methasani – Shumë faleminderit, zonja Ministre!

Zoti Dervishi, keni kërkuar fjalën? Jo.

Zoti Dyrmyshi? Zonja Ibrahimaj?

Arjan Dyrmyshi – Faleminderit, Eralda!

Faleminderit, edhe për prezantimet!

Unë jam Arjan Dyrmyshi, drejtori Ekzekutiv i Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes.

Në fakt, lidhur me tematikën, sigurisht qeverisja e hapur presupozon llogaridhënien, por transparenca është element i llogaridhënies, sepse ka të bëjë me informimin dhe njerëzit e painformuar nuk kanë se si të kërkojnë llogari, kështu që harmonizimi i të dyja temave është i rëndësishëm në këtë rast dhe është diçka e mirë. Unë mendoj se në diskutimin për transparencën në Shqipëri në përgjithësi mungon ndërlidhja e transparencës me ciklin e politikave. E përmendi pak zonja Dhuka, por po e them për ata që ndoshta nuk e kanë parasysh. Cikli i politikave presupozon identifikimin e politikave, formulimin, zbatimin dhe rishikimin. Konteksti ynë i diskutimit fokusohet vetëm në pjesën e dytë, pra në formulimin e politikës, jo në identifikimin e saj. Ajo që përmendi zonja Dhuka lidhet me identifikimin, që është totalisht jashtë vëmendjes. Të gjithë diskutimin ne e bëjmë për këtë pjesë të segmentit dhe le të themi që kemi arritur suksese, çka më çon te pika e dytë, për të cilën do të flas pak më vonë, që ka të bëjë me matjen, pra se si e matim transparencën. Një pjesë shumë e fragmentuar e transparencës ka të bëjë me zbatimin. Edhe kjo lidhet me matjen në disa aspekte, por është një element që ka të bëjë me zbatimin dhe, faktikisht, në takime të ngjashme e kemi diskutuar përpara 2 vjetësh me Koordinatorin kundër Korrupsionit, gjatë kohës së hartimit të strategjisë kundër korrupsionit, sepse praktikisht transparenca nuk lidhet me antikorrupsionin. Mirëqeverisja presupozon që transparenca ka nevojë që njerëzit të informohen, që qeveria të ketë të dhëna sa më të besueshme e të tjera, por ka mungesë të raporteve të institucioneve dhe këtu po flas për ekzekutimin. Asnjë ministri nuk ka raport vjetor,

agjencitë e mëdha nuk kanë raporte vjetore. Për shembull, Policia e Shtetit, që është agjencia më e madhe në vend, nuk ka raporte vjetore, që të gjurmosh ekzekutimin e politikave në vite, ose, kur ka raporte, në to flitet për numrin e krimeve e të tjera. Faktikisht, kjo pikëpritet edhe me fushat e politikave, sepse janë disa elemente, si buxheti, zbatimi, qoftë edhe i transparencës nga ana e institucioneve. Pra, ka një seri elementesh të cilat duhet të ishin në këto raporte vjetore, për të pasur një pamje sa më të plotë të zbatimit të politikës dhe të matjes së saj në mënyrë longitudinale në vite. Për shembull, në mënyrë periodike ne kryejmë matje të opinionit publik për çështje të sigurisë, të cilën e quajmë “Barometri i sigurisë”, por përpara 2 vjetësh i kemi dedikuar një kapitull edhe matjes së transparencës dhe antikorrupsionit dhe kemi pyetur shumicën e qytetarëve nëse mendojnë që në 3-5 vjetët e fundit është rritur transparenca...

Eralda Methasani – Ju lutem, keni pak kujdes me kohën!

Arjan Dyrmishi – Kjo për arsyen sepse shumica e raporteve fokusohet tek imputet, pra se çfarë po bëjmë. *Output*-i është opinionit publik, pra se sa transparençë ka sipas opinionit publik dhe në këtë aspekt, të paktën, matjet që ne kemi bërë tregojnë se nuk ka rritje të transparencës në vite.

Eralda Methasani – Shumë faleminderit!

Besoj se në vijim do t’i jepet mundësia gjithsecilit t’i dërgojë mendimet e veta, edhe të detajuara, në lidhje me procesin, i cili absolutisht nuk mbyllet sot.

Zoti Dervishi, e dëshironi ende fjalën?

Besnik Dervishi – Natyrisht, si institucion përgjegjës, edhe mund ta anashkalojmë, sepse, në fakt, unë mendoj se më mirë flasim raportet tona dhe puna jonë e përditshme.

Në radhë të parë, shumë shkurt unë doja të bëja një vlerësim për punën e komisionit në veçanti, edhe për shkak të eksperiencës, sepse (për herë të parë në Kuvend unë kam hyrë më shumë se 20 vjet më parë dhe në pozicione të ndryshme) është hera e parë që në Kuvend konkurrohet me kaq shumë profesionalizëm dhe mendoj se kjo është një risi të cilën duhet ta vlerësojmë të gjithë.

Gjithashtu, dua të bëj një falënderim të veçantë për ekspertët, sepse e drejta për informim, të paktën këta 10 vjet, kur është miratuar ligji i ri “Për të drejtën e informimit”, është vënë në fokus të ekspertëve, të shoqërisë civile, pse jo edhe të medias dhe të të gjitha grupeve të interesit dhe kjo është diçka shumë e rëndësishme që i shërben vendit, u shërben qytetarëve, natyrisht u shërben edhe institucioneve për atë që bëjnë mirë dhe që vlerësohet, por edhe për atë që, sigurisht, duhet ta bëjnë akoma më mirë.

Shkurtimisht dua t'ju them dy gjëra. Ashtu siç administrata jonë publike ka dhënë prova pozitiviteti, duke treguar një integritet të lartë profesional në procesin *screening*, mendoj se të njëjtin angazhim duhet të ketë edhe në raport me transparencën. Në këtë pikë do t'ju thosha, siç e përmendi edhe ministrja Pirdeni, se ne kemi vendosur një partneritet shumë të mirë, i cili besoj se mund të shërbejë si shembull edhe me të gjithë interlokutorët e tjerë. Ne e konsiderojmë veten partnerë me grupet e interesit, me shoqërinë civile, me median, pse jo, me autoritetet publike, por ky partneritet duhet të respektohet nga të gjitha palët.

Dua t'ju them shkurtimisht diçka që është motoja e punës sonë të përditshme, që nuk e kemi shpikur ne, por e ka thënë një mendje e shquar rreth 200 vjet më parë (pra kuptohet se sa e rëndësishme është transparenca, edhe pse, me siguri, ju e dini, shumica këtu e di që edhe ligji i parë për të drejtën e informimit është bërë rreth 250 vjet më parë), Xhejms Medison, i cili ka shkruar se një qeveri publike pa informacion publik ose që nuk ka nocionin e dhënies së tij është prologu i një farse apo tragjedie, apo ndoshta të dyja bashkë; dija duhet të qeverisë gjithmonë mbi injorancën dhe një popull që synon të jetë zot i vetes duhet të armatohet me fuqinë që të japin njohuritë.

Ne, për fat, kemi një ligj shumë të mirë, i cili vlerësohet në *top ten*, është edhe në *top five* po të duam, pavarësisht se ndryshimet apo përmirësimet shumë të mira që iu bënë vitin e kaluar ligjit “Për të drejtën e informimit” mund ta rendisin atë edhe në podium, kemi një instrument ligjor shumë të rëndësishëm, që është programi i transparencës.

Gjithashtu, do të doja të bëja edhe një koment të vogël sa u takon rekomandimeve të zyrës së Komisionerit, sepse neve nuk na ka ndodhur që të mos na kthehet përgjigje, siç për fat të keq i ka ndodhur Avokatit të Popullit, në përgjithësi na janë kthyer përgjigje. Po ashtu, edhe rekomandimet tona zbatohen në një nivel shumë të lartë. Ndoshta kjo ka lidhje me efikasitetin, por ndoshta ka lidhje edhe me ato që parashikon ligji, me sanksionet, pavarësisht se ne sanksionet nuk i shohim si mjet represiv, por i shohim si mjet edukimi.

Dua të përcaktoj edhe diçka tjetër të vogël, që marrëdhëniet e IKDNJ-ve, që janë Institucionet Kombëtare të Drejtave të Njeriut, siç janë Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ai për Informimin, patjetër, me shoqërinë civile, me median apo çdo grup interesi, aq më shumë me autoritetet publike, duhet të mbështeten në luajalitetin institucional. Pse e them këtë? Sepse një autoritet publik nuk mund të mos jetë i sinqertë me Komisionerin, nuk ka eksperiencë europiane, edhe më gjerë, gjë me të cilën ne jemi ndeshur, që

Komisioneri për të Drejtën e Informimit të japë një rekomandim ndaj një autoriteti publik dhe autoriteti publik të mos e zbatojë atë në mënyrë vullnetare, pra nuk ndodh, nuk ka eksperiencë, dhe kjo është kultura që duhet të imponojmë.

Natyrisht, unë nuk po kërkoj të eliminojmë ato që parashikon ligji nga pikëpamja procedurale, rishikimin gjyqësor të akteve të Komisionerit, por ama ne duhet ta kultivojmë këtë ndjenjë dhe këtë kulturë të luajalitetit institucional.

Do të doja të thosha shkurtimisht dy fjalë, meqë u prek çështja e pushtetit vendor. Në bashkëpunim me një nga shoqatat e shoqërisë civile, do të thosha më ekselentet në bashkëpunimin që kanë pasur me ne dhe në kontributin në pushtetin vendor, me IDM-në, kemi miratuar një program model të transparencës dedikuar për pushtetin vendor, i cili, pavarësisht se ka disa vjet dhe vitin që vjen do t'i nënshtrohet, nëse nuk gabojmë (le të më korrigjojë drejtoresha), edhe rishikimit të tij, sepse është detyrim ligjor, dua t'ju them se është një instrument ligjor. Ne nuk kemi pse të shpikim instrument ligjor për të matur performancën e bashkive. Programi i transparencës nuk duhet të jetë element i sistemeve të tjera që matin performancën e bashkive, por duhet të përfshijë edhe instrumente të tjera për ta matur atë. Pra, në këtë pikë unë mendoj se në qoftë se ne do të arrijmë ta realizojmë këtë do të ndërthurim në mënyrë shumë të rëndësishme dy komponentë që zgjidhen me të njëjtin sistem në të njëjtën platformë dhe me një rregullim ligjor që tashmë ekziston.

E fundit, dua të them diçka edhe për konsultimin publik, sepse është një temë shumë e rëndësishme. Janë dy ligje që janë miratuar në të njëjtën kohë dhe janë konsideruar dhe konsiderohen si *sunshine laws*, dy ligje që ndriçojnë skutat e errëta të administratës publike, të paktën kështu konsiderohen në literaturë nga shoqëria civile. Unë nuk po u referohem komenteve tona, sepse ne mund të kemi mendimet tona. Zyra e Komisionerit është përgjegjëse 100% për ligjin “Për të drejtën e informimit”. Ka disa elemente të trajtimit të ankesave vetëm sa i përket njoftimit dhe konsultimit publik, dhe këtu do t'u referohesha fjalëve të Gertit, i cili tha se këtu nuk ka një institucion përgjegjës. Po, ka një institucion përgjegjës, është ministri për Inovacionin, por që për shkak të detyrave të tjera të rëndësishme që ai ka, kjo detyrë harrohet ose bie në hije. Ky ishte një sugjerim që ka dalë edhe nga raportet e shoqërisë civile, të cilat ne i kemi mbajtur shënim, por ndoshta duhet parë edhe rregullimi institucional i ligjit, sepse nuk ka arsye pse dy ligje që janë të barabarta në rëndësinë dhe në funksionin e tyre të kenë dy vlerësime të ndryshme. Ligji “Për të drejtën e informimit” vlerësohet relativisht mirë dhe është në *top ten*, siç u tha këtu, ndërsa ligji “Për njoftimin dhe konsultimin publik” paraqet problematika.

Ju falënderoj dhe ju uroj suksese!

Eralda Methasani – Shumë faleminderit!

Zonja Trebicka e ka fjalën. Më pas zonja Haçkaj.

Ju lutem, kini parasysh kohën!

Jolanda Trebicka – Përshëndetje!

Unë do të flas shkurtimisht. Këtu u përmendën shumë elemente, por çështja që unë e kam me shumë merak, edhe zonja ministre e përmendi, është ajo e informimit të qytetarëve për detyrimet që kanë, ashtu si edhe për përfitimet. Deri më sot, të jemi të sinqertë, është folur shumë për përfitimet, por është folur pak për detyrimet. Kjo duhet të fillojë si me administratën, ashtu edhe me qytetarët, që të ndërgjegjësohen për rregullat dhe për çdo gjë që duhet të realizohet në kuadër të procesit të integritetit europian, për të mos pasur më pas procese të cilat mund të jenë të dhimbshme, në kuptimin e zbatimit të detyrimeve. Këta jua them ndoshta me kompetencë, sepse kam 7 vjet që merrem me këtë gjë në nivelin vendor. Në momentin kur qytetarët janë informuar për një rregull që ka nxjerrë Komisioni Europian, shkeljet kanë qenë më të pakta. Për këtë unë falënderoj zonjën ministre, që e ngriti këtë problem!

Sa i takon punës që është bërë nga kolegët, i përgëzoj! Keni bërë një analizë shumë të mirë, por kam vetëm një rekomandim dhe do t'ju lutesha ta vendosnit. Natyrisht që ne duhet të shohim atë çka është thënë në progresraport, ose çfarë kanë thënë institucionet, por duhet të kemi parasysh edhe një gjë: institucionet duhet të mbështeten, sepse, nëse nuk mbështeten me mekanizma, sado që të jetë vullneti politik apo vullneti administrativ, është e pamundur. Nëse do të merrja si shembull pushtetin vendor, me të cilin, siç jua thashë, kam punuar gjatë këtyre viteve, sa i takon transparencës bashkitë kanë nevojë për mbështetje qoftë në teknologjinë e informacionit, qoftë edhe në ndërgjegjësimin e drejtuesve si të këshillave bashkiakë, ashtu edhe të kryetarëve të bashkive.

Këtu kam një thirrje për AKSHI-n, meqë zoti Elezi e ngriti si çështje, natyrisht, ka pasur shumë..., donatorët janë munduar nëpërmjet asistencave që t'u japin asistencë institucioneve publike, që të ketë mundësi të ngrihen sisteme të caktuara.

Ndoshta kjo duhet parë pak, Ermal, që edhe në programin që ka AKSHI të jetë pak më i hapur dhe më fleksibël, sepse nuk mund të presësh derisa të miratojë AKSHI për 2 vjet termat e referencës për të ngritur një sistem.

E di shumë mirë, se kemi folur, dhe jam shumë dakord me faktin që çdo gjë duhet të lidhet edhe me elementet e sigurisë, sepse është vuajtur elementi i sigurisë, por kjo është një thirrje për AKSHI-n, që të jetë më i hapur ose programi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk po flas për programin e transparencës, por po flas për sistemet që duhen ngritur.

Ermal Elezi – Nëpërmjet programit të transparencës i bashkëngjiten sistemit.

Jolanda Trebicka – Në rregull.

Ermal Elezi – Është edhe detyrim ligjor.

Jolanda Trebicka – Atëherë, të merren masa. Unë e kisha thjesht që të vendoset si rekomandim, të vendosen instrumente, të investohet tek instrumenti, sepse ndonjëherë një instrument është më i rëndësishëm dhe ndihmon më shumë për transparencën. Neve, si ekspertë, shpeshherë kur na duhet futemi nëpër *site*-t e ministrive, marrim informacionin pa dashur ta shqetësojmë zyrtarin, sepse e kemi atë. Për hir të së vërtetës, unë flas nga eksperiencia ime, sepse kam 20 vjet që e monitoroj qeverinë, është bërë shumë në aspektin e transparencës, të paktën për transparencën në dokumentet publike. A ka punë për t'u bërë? Po. Do t'u lutesha ndërmarrjeve, nuk e di se kush e ngriti si çështje, Gjergji apo dikush tjetër, SOE-ve dhe sh.a.-ve, që ta shohin, pasi aty duhet transparencë e madhe, sepse ajo është gropë.

Faleminderit!

Eralda Methasani – Zonja Haçkaj.

Më falni, zonja Brahaj!

Aranita Brahaj – Unë quhem Aranita Brahaj dhe drejtoj një organizatë AIS, por që të gjithë e njohin si *Open Data Albania*. Jam në këtë tryezë, sepse, në fakt, më pëlqen shumë transparenca dhe duket sikur e kemi të lehtë, sepse fillon me tri linja por standardi i transparencës është një standard që kërkon shumë sfida për të realizuar institucionet dhe aktorët e tjerë.

Unë do të pohoj, por jo me eufori e me entuziazëm, faktin që ne kemi një legjislacion shumë të mirë. Pra, ne kemi një nga ligjet për të drejtën e informimit, që unë do ta kisha quajtur 'e drejta e informimit dhe programi i transparencës', sepse jo vetëm që i jep qytetarit të drejtë ligjore të kërkojë informacion, por jep garanci që drejtuesi ose një institucion të vendosë *online* të dhëna që kanë të bëjnë me transparencën pa u identifikuar interesi i kërkuarit apo i qytetarit.

Nga ana tjetër ne kemi edhe legjislacion për *open data* apo për të drejtën për ta ripërdorur informacionin, i cili është informacion shtetëror. Besoj se pak vende e kanë, ndaj mendoj se është

gjë e mirë që Shqipëria, të paktën si standard legjislativ, e ka arritur në një kohë të shpejtë e të mirë.

Nga ana tjetër do të doja që nga kjo analizë, me dëshirën për të qenë një plan pune për institucionet, në radhë të parë për institucionin e Parlamentit, të shtoj e të rendis edhe bazën ligjore që rregullon disa elemente shumë të rëndësishme të transparencës. Vetëm në këtë letrën ku mbajta shënime unë mund të rendis dhjetë-pesëmbëdhjetë akte ose ligje, të cilat rregullojnë funksionimin e regjistrave publikë. Pra, ne kemi regjistra për biznesin, për pronarët përfitues, kemi regjistra për OJF-të, të cilët duhet të funksionojnë. Ka bazë ligjore, se regjistri nuk funksionon ende. Kemi regjistra për funksionimin e gjyqësorit, për funksionimin e shumë institucioneve të tjera, qoftë edhe për profesionet e lira, të cilat pasi marrin një licencë publike janë të detyruar të jenë të ekspozuar *online*.

Mund të bëjmë një listë, e cila për të qenë shteruese ka nevojë për shumë bashkëpunëtorë. Do të duhet të shikojmë se ku ka nevojë për përmirësim ky legjislacion, dhe çfarë nuk ka shkuar ashtu si duhet, se pse ligji nuk është kuptuar, nuk është buxhetuar ose pse nuk është zbatuar siç duhet. Kjo lidhet me programin e transparencës dhe integrimin, sepse vetëm nëse unë do të përmend një nga kapitujt e rëndësishëm të *Cluster One*, që është prokurimi publik, vërehet se aty janë tre regjistra, të cilët janë detyrime ligjore: regjistri i parashikimeve, regjistri i realizimeve, e në fund regjistri që ka të bëjë me PPP-të, që janë gjithashtu prokurime, në lidhje me të cilin kemi një rekomandim për ta bërë ligjin nga e para, por ndërkohë baza ligjore ka ekzistuar.

Pra, mendoj se, që të bëjmë një plan veprimi duhet t'i analizojmë, të shohim ku ka nevojë për ndërhyrje, por edhe ta ngarkojmë institucionin, Parlamentin, që të bëjë një plan të mekanizmit të kontrollit të institucioneve të pavarura, që janë kompetencë e tij, por edhe të ekzekutivit, plan vjetor ose afatmesëm, i cili të na tregojë se si është ecur me këto regjistra, si është ecur me këto standarde ligjore.

Do të vazhdoj me Parlamentin, pasi mendoj se Parlamenti ka marrë përsipër të veprojë, ndaj ja ku jemi këtu që po, një plan veprimi ka një listë shumë të mirë të elementeve për të bërë. U fol për konsultimin publik, por maja më e rëndësishme e këtij vargmali, që është konsultimi publik nga qeliza e pushtetit lokal tek institucione të pavarura apo të ekzekutivit, është vetë Parlamenti, aktet e procesit legjislativ. Ne kemi kohë që dëgjojmë partnerët, por edhe Parlamentin, të angazhohen për të përmirësuar publikimin e akteve ligjore, por edhe të akteve që lidhen me

procesin, që nga prezantimi i një iniciative e tek të gjitha dokumentet që e shoqërojnë deri në finale miratimin dhe hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Unë shpresoj shumë se në këtë plan veprimi vetë Parlamenti, e ndoshta këtu përfitoj nga rasti që ndodhem përpara disa përfaqësuesve politikë të Parlamentit, të cilët shpresoj se do të jenë edhe në legjislaturën e ardhshme, që në 2025-ën të fillojnë një legjislaturë të re me një platformë më të mirë të *e-legislation*, të paktën për pjesën e punës së vetë Parlamentit. Ndoshta dola pak nga transparenca e Parlamentit, por mendoj se në këtë rast është shteti, nuk është thjesht Parlamenti. Pra, të jetë edhe procesi *tracking*, se çfarë ka ndodhur me iniciativën, si është amenduar, si është parë, si është realizuar, por edhe mënyra se si është zhvilluar konsultimi publik.

Po te Parlamenti është një nga rekomandimet për tryezat e shumta të shoqërisë civile me Parlamentin. Dua të përgëzoj jo vetëm institucionin e Parlamentit, por edhe përfaqësuesin e një institucioni, i cili ka punuar shumë për zhvillime të qeverisjes së mirë e të hapur. Parlamenti e ka nënshkruar ose e ka angazhuar veten në deklaratën e *Open Parliament*, por aty ka shumë standarde për të realizuar, ndaj unë do ta këshilloja Parlamentin që në hartimin e planveprimit të ketë edhe një plan të partneritetit me organizata lokale, përveç aktorëve ndërkombëtarë, ku secila nga organizatat të fokusohet edhe te një nga kriteret që i kërkohet. Pra, siç është bërë plani i veprimit nga qeveria qendrore, i cili patjetër që në kohë të ndryshme ka pasur rezultate të mira ose angazhime të mira, edhe Parlamenti ta konsiderojë si një partneritet këtë radhë me aktorët e shoqërisë civile.

Dua të them edhe diçka tjetër, për të cilën ndoshta më shumë pata nxitje nga bisedat e kolegëve, si për shembull nga zoti Elezi. Ka shumë platforma që ndërtohen edhe me asistencë të partnerëve apo të taksapaguesve të vendeve partnere europiane apo të huaja. Kjo është diçka shumë e mirë, por duhet të respektojë kompetencën. Për shembull, nëse ne duam të bëjmë një ndërhyrje për *Open Data* në një sektor të caktuar, kompetenca duhet respektuar. Ministria e Financave është kompetente për financat publike. Kjo ministri do të ekzistojë në çdo lloj kohe e në çdo lloj vendi, sepse është një nga funksionet bazë të shtetit. Ne mund të bëjmë ministri për fëmijët, për rininë, për sportet, pra mund të krijojmë ministri pa fund, por që gjërat të jenë afatgjata do të duhet të respektojmë funksionin bazë. Nuk mund të anashkalohet AKSHI, nëse një partner kërkon të bëjë një platformë për ndërhyrje teknologjike. Nuk mund të anashkalohet një institucion tjetër. Kësisoj, besoj se kjo vlen edhe për përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe donatorët, të cilët duhet

at fillojnë punën e tyre me një analizë pak më të saktë, më të qartë, por edhe me një target institucional shumë më funksional dhe kompetent.

Ju faleminderit!

Eralda Methasani – Shumë faleminderit, Arianita!

Ndjesë që ju nxis, sepse jemi gjysmë ore përtej kohe, por zonja Haçkaj dhe zonja lart e kanë kërkuar fjalën që në fillim.

Krisela Haçkaj – Jam Krisela Haçkaj, nga Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim. Shumë shkurt, një reflektim që më së shumti përfshihet në suazat e procesit të integritetit, në fakt të momentumit ku ndodhet vendi. Jemi në një qasje të përsheptuar, kemi një *time line* relativisht ambicioz. Flitet për vitin 2027 si kohë e mbylljes së negociatave, e për 2030-ën si vend anëtar. Kjo na ngarkon me përgjegjësi, detyra e obligime që të gjithëve, qoftë neve nga shoqëria civile, qoftë institucionet.

Bashkimi Europian vjen me një paketë instrumentesh financiare, që mbështesin vendin në këto ambicie. Së fundmi kemi edhe Planin e Rritjes. Në qoftë se instrumenti i paraanëtarësimit ka funksionuar në bazë projektesh, plani i rritjes funksionon në bazë reformash dhe investimesh. Kjo do të thotë se vjen me disa risi për sa i përket qeverisjes së instrumenteve. Prandaj diskutimi që zhvillohet në këtë komision është shumë i vlefshëm për të krijuar sinergji mendimesh e opinionesh dhe ofron një dritare mundësie shumë të mirë për të testuar kapacitetet e administratës, por edhe të aktorëve shoqërorë, që mekanizmat e qeverisjes së këtij instrumenti t'i përdorë për të aftësuar më shumë, që të përgatitemi të jemi vend anëtar pas 2030-s.

Më herët u diskutua koncepti i partneritetit. Ekzistojnë struktura që do të ngrihen në kuadër të planit, siç janë komitetet e monitorimit, të cilat mund të testohen dhe mund të pilotohen për të përfshirë shoqërinë civile, aktorë të specializuar, si nga biznesi ashtu edhe nga fushat e tjera, që të kontribuojmë në këtë përgatitje të aktorëve, në mënyrë që kur të jemi vend anëtar ta kemi të qartë se cilat janë detyrimet dhe pritshmëritë e vendit, por edhe të Bashkimit Europian.

Faleminderit!

Eralda Methasani – Faleminderit shumë!

Romina Kostani – Në fakt, unë doja të ndërhyja për dy çështje, po për t'iu përgjigjur edhe komentit të...

Eralda Methasani – Bëni një prezantim, ju lutem!

Romina Kostani – Po, ndjesë!

Jam Romina Kostani, drejtoresha e Agjendës Digjitale dhe Fondeve të Huaja, tek AKSHI.

Fillimisht, do të doja t'i përgjigjesha zonjës Trebicka në lidhje me komentin të bërë ndaj AKSHI-t.

Ju zonja Trebicka, e dini shumë mirë që prej më shumë se shtatë vjetësh ekziston një bazë ligjore, dhe se qeveria i ka dhënë AKSH-it mandatin e zhvillimit të sistemeve elektronike dhe qeverisjes elektronike në tërësi. Ka disa arsye pse është bërë një gjë e tillë. Arsyeja e parë ka të bëjë me standardet, për të garantuar standarde për zhvillim të njëjtë të shërbimeve elektronike. Arsyeja e dytë është siguria, që e përmendi edhe zoti Elezi. Shpeshherë ka ndodhur që kanë qenë donatorët ata që nuk janë koordinuar me AKSHI-n për ngritjen e sistemeve.

Ju e dini shumë mirë se AKSHI nuk vonon asnjë proces. Ju e dini shumë mirë se termat tona të referencës realizohen në kohë rekord, e po ashtu janë në kohë rekord edhe implementimet tona. Nëse nuk do të ishte kështu, ne nuk do të ishim vendi më i zhvilluar në Ballkanin Perëndimor sa i përket qeverisjes elektronike. Në takimet bilaterale që kemi pasur me Komisionin Europian, kemi marrë komplimente nga ana e tyre, që edhe vetë vendet anëtare të Bashkimit Europian do të kishin zili Shqipërinë. Këto nuk jam unë që i them, por është Bashkimi Europian që i thotë.

Kësisoj, ju lutem, siç u tha, duhet të bëhet koordinimi me AKSHI-n sa i përket zhvillimit të sistemeve elektronike me fondet e donatorëve.

Sa u përket dy çështjeve të tjera, do të doja të ndërhyja shumë shkurt për *Open Data*, duke qenë se është një ndër mjetet që garanton transparencën dhe llogaridhënien e qeverisë. Ne jemi duke punuar për të përmirësuar portalin “*Open Data*”, duke garantuar aplikimin e standardeve të Bashkimit Europian për portale të tilla dhe me asistencën teknike të Bankës Botërore do të punojmë për të bashkëpunuar dhe për të bashkërenduar me institucionet që kanë të dhëna të hapura për t'i ofruar ato në mënyrë transparente dhe automatike nga sistemet e tyre drejt portalit “*Open Data*”.

E dyta, që doja të theksoja, meqenëse u fol gjatë për procesin e integritetit, i cili është një ndër prioritetet e kësaj dekade për t'u përmbyllur në një kohë sa më të shpejtë, ne kemi një ngritur një sistem të dedikuar për sa i përket menaxhimit të procesit të integritetit europian, i cili është tashmë në përdorim nga e gjithë administrata publike dhe nga të gjithë negociatorët dhe grupet që menaxhojnë pjesën e integritetit në BE. Së fundi, kemi shtuar edhe një modul me inteligjencë artificiale për të përshpejtuar procesin e transpozimit të legjislacionit. Ky është një modul i zhvilluar fillimisht, prej më shumë se një viti, në bashkëpunim me “*Open AI*”, tashmë edhe me

Microsoft-in si partneri strategjik i qeverisë shqiptare, dhe do të jetë në punë për administratën. Duke përdorur inteligjencën artificiale, do të kemi mundësi që të shkurtojmë kohën e transpozimit të *acquis*-së së BE-së me legjislacionin shqiptar, gjithashtu të bëjmë një *check* të legjislacionit ekzistues me atë që pritet të transpozohet për të evidentuar ndryshimet dhe se ku duhet t'i bëjmë ndërhyrjet në legjislacionin tonë.

Faleminderit!

Eralda Methasani – Zoti Preçi, fjala për ju.

Zef Preçi – Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar deputetë dhe ministra të pranishëm,

Të nderuar kolegë të shoqërisë civile,

Telegrafisht do të ndalem në dy elemente: te pritshmëritë nga ky komision dhe dokumenti i përgatitur. Do të jap disa konsiderata për dokumentin dhe për rolin e shoqërisë civile. Natyrisht, sfida e përbashkët është si t'i konvertojmë taksat tona në shërbime publike. Pra, si të ndërtojmë ura midis tyre, si të kontribuojmë për t'i shëruar qytetarët nga dashuria për individin dhe të kenë kërkesë-llogari ndaj institucioneve. Në të njëjtën kohë, e kam parë që nga mbledhja e parë se ky komision ka kontribuar për të krijuar një klimë transparence te shoqëria civile, për të çmitizuar raportet e Kuvendit të Shqipërisë me organizatat e shoqërisë civile, njëkohësisht për të prodhuar raporte, analiza, studime, përgjithësime, opinione, perceptime e të tjera, të cilat nuk janë thjesht dokumente për t'ia paraqitur burokracisë së Brukselit, por që mund të kontribuojnë për ligjbërjen dhe vendimmarrjen në periudhat që vijnë.

Për sa i takon dokumentit, e shoh si një dokument pune dhe i përgëzoj kolegët (unë kam qenë te pjesa e llogaridhënies së institucioneve publike), sepse e shoh si një mundësi që gradualisht po e nxjerrim nga ato rreziqe, nga frika apo problematika të fillimit, kam parasysh (*scope of work*) angazhimin jo thjesht të shtetit në tërësi, por në administratën publike. Pra, institucionet e pavarura duhet të ndihen të çliruara që nuk janë subjekt i punës së këtij komisioni, por kjo nuk do të thotë që nuk janë subjekt i llogaridhënies, sepse ndarja e degëve të pushtetit është e qartë dhe përcaktohet edhe në Kushtetutë. Kjo ka bërë që të jemi të lirshëm në këtë komision. Këtë dokument, pa hyrë në detaje për rekomandimet specifike, që rezervoj të drejtën për t'i diskutuar kur t'u vijë radha, e shoh si një bazë nga ku mund të nxirret një plan veprimi dhe, natyrshëm, të harmonizohet kuadri

ligjor në fuqi me amendime, ndryshime apo edhe me një kuadër ligjor të ri atje ku është e nevojshme.

Për sa i takon shoqërisë civile, mendoj se janë pjekur kushtet për të shfrytëzuar kapacitetet e krijuara dhe që shoqëria civile të jetë më konkurruese dhe më pak e varur nga fondet e donatorëve. Pra, të mos jetë më një *money driven agency*, njëkohësisht, të jetë më pak e politizuar dhe e fokusuar më shumë te çështjet e mirëqeverisjes dhe luftës kundër korrupsionit në vend.

Faleminderit!

Eralda Methasani – Shumë faleminderit, zoti Preçi!

Po, fjala për ju, zoti Kamberi.

Geron Kamberi – Jam Geron Kamberi, nga Qendra për Studimet e Demokracisë dhe Qeverisjes. Thjesht doja të theksoj diçka në lidhje me çështjet e transparencës, të paktën edhe nga përvoja ime në kaq vjet. Besoj se tri shtylla duhet të jenë pjesë e studimit dhe duhet t'i kenë parasysh të gjitha institucionet, edhe nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Çdo institucion ka *uebsajtin* e vet, por, nëse hyn në *uebsajtet* e shumë institucioneve, ose gjen një informacione të mangët, ose nuk e gjen fare, ose shkëputet në një vit, ose fillon vitin që ka ardhur drejtuesja e atij institucioni. Pra, transparenca ligjore, transparenca institucionale dhe transparenca financiare janë tri shtylla, për të cilat ka nevojë qytetari apo edhe ne në rolin si studiues, përfaqësues të shoqërisë civile apo dikush tjetër i jashtëm. Ky informacion duhet jetë në dy gjuhë: në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, të paktën për transparencën për organizmat e tjerë ndërkombëtarë. Gjithashtu, gjykoj që ka ardhur koha, ndoshta ka kaluar, që kjo të jetë pjesë e një metodologjie të unifikuar që mund të vijë nga AKSHI apo nga agjencia përkatëse pranë qeverisë shqiptare dhe çdo institucion në të tria degët e qeverisjes, pavarësisht nivelit të autonomisë dhe pavarësisë, këto tri shtylla t'i ketë të garantuara, veçanërisht të jenë të garantuara seritë kohore.

Shteti shqiptar nuk ka lindur as në vitin 2014, as në vitin 2022, të paktën në këtë periudhë, pas vitit 1990 e deri më tani, çdo individ i shtetit shqiptar, që është i interesuar, mund të hyjë në *uebsajtin* e institucionit dhe të gjejë historinë institucionale dhe transparencën e tij në këto tri elemente.

Faleminderit!

Eralda Methasani – Faleminderit!

Kemi ndërhyrje të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Ministre, fjala për ju.

Adea Pirdeni – Shumë faleminderit për fjalën!

Dua të fokusohem në tematikën e dytë, e cila është llogaridhënia. Kur flasim për transparencë, ka interes shumë të lartë për t'u angazhuar në lidhje me këtë tematikë, por llogaridhënia mbart një rëndësi të veçantë, duke qenë se sistemi i llogaridhënies na bën të jemi më eficientë, mbi të gjitha. Sistemi që kemi aktualisht, i ndërtuar ndër vite, ka dëshmuar që funksionon në një masë të konsiderueshme. Për shembull, në vlerësimin e SIGMA-s, Shqipëria është mbi mesataren rajonale në këtë fushë, megjithatë mbeten ende çështje për t'u adresuar. Gjej rastin të përgëzoj një nga gjetjet më të rëndësishme të ekspertëve në lidhje me llogaridhënien për sa u përket institucioneve të pavarura. Gjetja juaj përkon me gjetjen e raportit të fundit të SIGMA-s, i cili thotë shprehimisht: nga 25 institucione, që raportojnë në Kuvend, 11 institucione janë tipike të natyrës administrative, të cilat janë rregullatore në fushën e utiliteteve, në fushën e telekomunikacionit, në fushën e energjisë e kështu me radhë, të cilat, sipas SIGMA-s, në shumë vende nuk janë institucione që raportojnë drejtpërdrejt në Kuvend, por raportojnë pranë ministrisë së linjës.

Ky është një debat dhe diskutim publik, ndaj mendoj që mund të bëhet edhe në këtë forum. Natyrisht, kjo është çështje që, sikurse e kemi diskutuar edhe me ekspertët e SIGMA-s, madje mund të them me shaka, diskutimi ynë ka qenë: kur i kemi ngritur këtë institucione, me ju i kemi konsultuar, nuk është se erdhëm vetë, me idenë që të krijojmë kaq shumë institucione të pavarura. Me sa duket, ky është diskutim që është ngritur në kuadër të OECD-së që në vendet, që ka shumë institucione të pavarura, problematikat e llogaridhënies mbeten të qenësishme kur bëhet fjalë për institucione administrative, jo institucione të gjyqësorit, ose institucione të pavarura të të drejtave të njeriut.

Ky është një diskutim që mendoj se mund ta ushqejë debatin në vijim, kështu që mbetemi të hapur për të diskutuar.

Ky është një diskutim që ushqen shumë të gjithë procesin e ndryshimit të ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Kemi nisur një punë shumë të mirë me projektin “*EU for Good Governance*”. Gjithashtu, kemi një draft që do ta nxjerrim shumë shpejt në konsultim publik dhe besoj që të gjitha rekomandimet, që do të vijnë nga komisionet, do të jenë shumë të vlefshme për ne.

Faleminderit!

Eralda Methasani – Faleminderit!

Fjala për zonjën Ekonomi.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Nuk do të bëj një ndërhyrje shumë të gjatë, por do të përfitoj nga rasti për t'ju vënë në dijeni për disa gjëra të shpejta. Kjo punë që ne kemi ndjekur nëpër tryeza (kjo tryezë është e parafundit, do të ketë edhe një tryezë tjetër të komisionit të posaçëm), është falë ekspertëve, që kanë ardhur me vullnetarizmin e tyre të madh, për të bërë një gjë që i shërben vendit. E them shumë shpesh këtë gjë, sepse besoj shumë fortë që njerëzit vijnë e duan të kontribuojnë, thonë një mendim, i cili bën mirë (kam disa shembuj të tjerë, që mbase nuk është momenti për t'i përmendur) dhe mendoj që duan të bëjnë diçka për fëmijët e tyre.

I falënderoj të gjithë ekspertët që kam punuar, sepse kanë dhënë kontribut shumë apo pak, por kanë shkruar me dëshirën për të bërë diçka, që kuadri i analizës të jetë i plotë. Në tryezat që ne kemi marrë pjesë, kanë qenë tryeza që kanë pasur qëllim të shtohen elemente, që ekspertët nuk i morën në konsideratë dot të gjitha, iu shpëtuan nga leximi, që të pasurojnë analizën. Në momentin që pasqyrohet analiza lind një detyrë tjetër, disa nga ju e përmendën shumë shpesh planin e veprimit, në fakt, ajo që po bën komisioni i posaçëm, pas këtij momenti, ku grumbullohen të gjithë elementet e analizës, është plani i veprimit. Çfarë do të bëjë Parlamenti për ta zhvilluar më tej këtë frymë konsultimesh dhe nevojë për të bërë *brainstorming* për çështje të rëndësishme? Çfarë detyrash do të konsiderojë Kuvendi, që nuk i ka ekzekutivi, por mund ta çojë më tej transparencën, llogaridhënien, shërbimin, luftën kundër korrupsionit, ndërgjegjësimin për përdorimin e ligjit, mënyrën se si do të rriten qytetarët shqiptarë për të qenë qytetarë europianë? Këto gjëra do të bëjnë që të ketë një bashkëpunim më të madh me shoqërinë civile.

Kështu që, plani i veprimit në Parlament nuk është një plan veprimi vetëm i ekzekutivit, atë që ka ardhur nga detyrat që kanë dalë në *screening*, por është edhe më tej. Për shembull, Landa sot përmendi ndërmarrjet publike, që kanë të bëjnë me një transformim që po ndodh në Kuvend lidhur me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave për të pasur modele, që i kanë edhe vendet e rajonit, për detyrat që kryen ky komision për monitorimin e buxhetit. Të gjitha këto do të futen në një plan veprimi, i cili do të jetë përsëri objekt i konsultimeve në këto tryeza. Përveç kësaj, do të jetë konsultimi që do të bëhet në tryezat lokale, ku do të përdoret e njëjta prurje intelektuale, që ka të bëjë me shoqërinë civile lokale, universitetet dhe shoqatat e biznesit, sepse atje nuk bëhet fjalë për institucione të pavarura, ato janë më shumë në nivel qendror, por bashkitë mund të kenë atë që

ne e quajmë *town hall* dhe mund të thërrasin elemente të tjera për ta bërë që kjo mendësi e re e integritit të shkojë edhe në nivel lokal.

Kështu, duke thënë këto gjëra, personalisht dua të falënderoj të gjithë ata që na kanë ndihmuar në këtë proces! Gjithashtu, dua të them që ky proces nuk do të ishte i mundur nëse në krye të kësaj pune nuk do të ishte Fatmir Xhafaj, pasi jo vetëm që e pati si ide, por edhe na nxitu për të shkuar drejt detyrës (të më falësh shumë zoti Xhafaj, por më vjen ta them) dhe të mbajmë në konsideratë që ky nuk është një proces i deputetëve, ky është një proces jashtë Kuvendit! Nëse kemi një gjë, që na thuhet vazhdimisht neve që jemi angazhuar në këtë proces, është pikërisht kjo: nuk është një proces i deputetëve, por është një proces që vjen nga shoqëria shqiptare, nga të gjithë ata që janë të interesuar për ta çuar përpara këtë angazhim të madh, siç është integrimi europian.

Faleminderit!

Eralda Methasani – Shumë faleminderit, zonja Ekonomi!

Ne kemi mbajtur shënime, sigurisht, minutat do të zbardhen; diskutimet ishin shumë të frytshme, kemi mbajtur të paktën rreth 30 shënime konkrete, me sugjerime konkrete, të cilat adresojnë saktë çështjet e transparencës dhe të llogaridhënies.

Migena, a doni të thoni diçka?

Migena Leskoviku – Ju falënderoj të gjithëve për komentet!

Ne e përmendëm edhe në krye të herës, që ka vend për përmirësim.

Falënderoj Adean që bëri ndërhyrjen, pasi ma mori komentin pse e kemi bërë atë qasje në raport, në të njëjtën kohë, edhe një element tjetër, që lidhet me llogaridhënien, e cila është sa e brendshme, aq edhe e jashtme. Në këtë drejtim ne kemi përfshirë edhe institucionin e Avokatit të Popullit dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Nuk është qëllimi i pjesës sonë që të theksojmë analizën dhe çfarë pune bëjnë këto institucione të pavarura kushtetuese, por vetëm në kuadër të llogaridhënies për efekt të detyrimeve që kanë institucionet e ndryshme të pushtetit qendror apo vendor në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të tyre.

Kur Avokati i Popullit apo KLSH-ja japin rekomandim, i japin si për burgjet, si për shëndetësinë, si për arsimin, si për policinë; është një çështje që ndoshta do të adresohet në planin e veprimit.

Ndërmarrjet shtetërore...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, unë e përmenda dhe ishte një nga elementet që është specifike në raportin tonë të llogaridhënies. Nëse do të ketë nevojë për ta zgjeruar, ashtu si edhe elemente të tjera, mbetemi të hapur që pjesën e ndërmarrjeve shtetërore ta zgjerojmë më tej.

Faleminderit!

Eralda Methasani – Çështjet janë vërtet shumë, do të mbahen të gjitha në konsideratë, pasi ka vend për diskutime të mëtejshme. Në rastin e hartimit të planit të veprimit, do të ketë vend edhe për ndërveprime shumë intensive.

Shumë faleminderit për pjesëmarrjen!

Faleminderit që qëndruat, pasi koha ishte përtej asaj që ishte parashikuar!

MBYLLET MBLEDHJA

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Koordinatore e Komisionit
Anida Fejazaj